



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:044586

Datë: 04.04.2024

Numri i dokumentit: 05548074

PKR.nr.108/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-Departamenti për Krime të Rënda, trupi gjykues i përberë nga gjyqtarët: Ilir Rashkaj, kryetar, Sulltan Dobraj dhe Samedin Cena, anëtarë të trupit gjykues, me bashkëpunëtorin profesional Zef Qupi, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.SH., nga Gjakova, dhe të akuzuarit M.XH., nga Gjakova, secili veç e veç, për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 2 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.04/2022 të datës 25.07.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 09.09.2022, dhe shqyrtimeve gjyqësore publike, me datë 15.12.2022, 08.02.2023, 24.03.2023, 28.04.2023, 20.06.2023, 04.08.2023, 16.11.2023, 13.02.2024 dhe 05.03.2024, në prezencë të përfaqësueses së Prokurorisë Themelore në Prizren-Prokurores së Shtetit Ervehe Gashi, të akuzuarit A.SH., dhe mbrojtësit të tij, av. Meshari Selimaj, si dhe të akuzuarit M.XH., dhe mbrojtësit të tij, av. Korab Bokshi, me datë 07.03.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 04.04.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

*Ndaj të akuzuarve:*

1. A.SH., nga i ati ... dhe e ëma... e lindur Xh., i lindur me datë ..., në Gjakovë, me banim në rr. "...", nr..., me profesion ujësjellës, ka të kryer shkollën e mesme teknike, i gjendjes se mesme ekonomike, i martuar, i ati i një fëmijë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. të letërnjoftimit ..., më parë i dënuar sipas aktgjykimit P.nr.296/20, për shkak të veprës penale nga neni 269/1-2 të KPRK-së, me dënim me gjobë në shumën prej 300 Euro, dhe i njëjti është bërë i plotfuqishëm me datë 22.01.2021.

2. M.XH., me nofken ..., nga i ati .... dhe e ëma .. e lindur B., i lindur me datë ....., në Gjakovë, me banim në rr. "...", p.nr., me profesion kuzhinier, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes se dobët ekonomike, i martuar, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës, me nr. personal të letërnjoftimit ..., më parë i padënuar.

J A N Ë F A J T O R Ë

*I akuzuari A.SH.,*

Sepse, nga data e pavërtetuar e deri me dt.30.04.2022, në Gjakovë, pa autorizim shpërndan, shet, transporton, dorëzon, ndërmjetëson, dërgon substanca psikotrope ose analoge të shpallura të rrezikshme në kundërshtim me nenin 9, dhe nenin 14 të Ligjit për barnat narkotike, substanca psikotrope dhe prekusore nr.02/L-128, dhe atë të llojit kokainë me qëllim të shitjes, në atë mënyrë derisa i njëjti ndodhej nën masa të fshehta vëzhgimi nga ana e Njësisë së Hetimit për Trafikim me Narkotik në Gjakovë, prej disa muajve është marrë me shitje të substancave narkotike të personat e ndryshëm në qytetin e Gjakovës, fshatrat e komunës së saj dhe edhe me gjerë, shitje dhe shpërndarje duke e bërë me përdorimin e veturës së tipit, “. . .”, ngjyrë e gjelbër, me trg...., “. . .”, me trg. ... dhe “Ford Focus”, ngjyrë hiri, me targa ... ashtu që natën kritike rreth orës 23:58 min, nga bastisja e realizuar policore në shtëpinë e tij, në rr. “....”, i janë gjetur në oborr, në shemshira dhe brenda ollukut të shtëpisë 229 qese, të tejdukshme, të mbyllura me nxehtësi që përmbanin substancë pluhuri me ngjyrë të bardhë të llojit kokainë, dhe ato në përbërje prej: një qese në sasi prej 0.34 gram, një qese në sasi prej 0.39 gram, një qese në sasi prej 0.36 gram, një qese në sasi prej 0.39 gram, 14 të qese në sasi bruto prej 5.89 gram, 45 qese në sasi bruto prej 18.82 gram, 46 qese në sasi bruto prej 19.31 gram, 45 qese në sasi bruto prej 18.49 gram, 35 qese në sasi bruto prej 16.41 gram, 40 qese në sasi bruto prej 16.30 gram, të gjitha së bashku në peshë të përgjithshme prej 87.59 +- 0.0001gram, konstatuar sipas raportit të ekspertimit AKF/2022-1580/2022-1528 të dt.30.05.2022, ku ka treguar se prezent është substanca narkotike e llojit kokainë, e cila më pas është konfiskuar nga policia.

-Me këto veprime ka kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paaautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 2 të KPRK-së.

## II.

*I pandehuri M.XH.,*

Sepse, nga koha e pacaktuar e deri në fillim të Marsit të vitit 2022, në Gjakovë, pa autorizim shpërndan, shet, transporton, dorëzon, ndërmjetëson, dërgon substanca psikotrope ose analoge të shpallura të rrezikshme në kundërshtim me nenin 9 dhe nenin 14 të Ligjit për barnat narkotike substanca psikotrope dhe prekusore nr.02/L-128, e me qëllim të shitjes, në atë mënyrë që derisa i njëjti ndodhej nën masa të fshehta vëzhgimi nga ana e Njësisë së Hetimit për Trafikim me Narkotik në Gjakovë, është marrë me shitje të substancave narkotike të personat e ndryshëm në qytetin e Gjakovës duke marrë pagesat menjëherë nga klientët me të dorëzuar kokainën për çka i njëjti për këtë veprimtari kishte marrë në shfrytëzim prej të pandehurit A.SH., veturën e markës “. . . Laureate”, me targa ...., e të cilin automjet fillimisht e kishte në shfrytëzim i pandehuri A...dhe nga koha që i pandehuri A.. ka marrë tjetër veturë në përdorim si atë të tipit . . ., ngjyrë e zezë, me targa ..., i pandehuri M.. me anë të kësaj veture ka shpërndanë, ndërmjetësuar dhe shitë tek personat e tretë, përkatësisht personave E.S-T., dhe A.B., në mënyrë të kundërligjshme substanca narkotike me qëllim të përfitimit material dhe se nga arrestimi i të njëjtit i janë gjetur

dhe konfiskuar mjetet monetare 657 €, 17 USD, 70 funta angleze dhe 100 franga zviceranë dhe 3000 lekë të R. së Shqipërisë, e të cilat më pas ia konfiskon policia.

-Me këto veprime ka kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 prg.2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 8, 17 par. 1, 21, 38, 39, 40 par 1, nën-par 1.2. dhe 1.3., 42, 43, 44, 69 e 70, 71 e 72, nenit 267 par.2 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPP-së, të akuzuarit i:

## G J Y K O N

### I.

I. Të akuzuarin A.SH., dhe e dënon me *Dënim me gjobë në shumën prej dymijë (2.000) € dhe Dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) viteve*, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të realizohet konform nenit 43 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi, në kohëzgjatje prej njëqind (100) ditësh, duke llogaritur çdo njëzet (20) € me një (1) ditë burgim.

Koha e kaluar në paraburgim nga data 30.04.2022 deri me datë 24.01.2023, do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

### II.

Të akuzuarin M.XH., dhe e dënon me *Dënim me gjobë në shumën prej një mijë e pesëqind (1.500) € dhe Dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti e tre (3) muaj*, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të realizohet konform nenit 43 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi, në kohëzgjatje prej shtatëdhjetë e pesë (75) ditësh, duke llogaritur çdo njëzet (20) € me një (1) ditë burgim.

*Të akuzuarit A.SH., i konfiskohen:*

- 229 qese të tëjdukshme me substancë pluhuri, me ngjyrë të bardhë, të llojit kokainë, dhe ato në përbërje prej: një qese në sasi prej 0.34 gram, një qese në sasi prej 0.39 gram, një qese në sasi prej 0.36 gram, një qese në sasi prej 0.39 gram, 14 të qese në sasi bruto prej 5.89 gram, 45 qese në sasi bruto prej 18.82 gram, 46 qese në sasi bruto prej 19.31 gram, 45 qese në sasi bruto prej 18.49 gram, 35 qese në sasi bruto prej 16.41 gram, 40 qese në sasi bruto prej 16.30 gram, të gjitha së bashku në peshë të përgjithshme prej 87.59 + -.0001gram,

Urdhërohet Stacioni Policor në Gjakovë, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të bëjë shkatërrimin e substancave narkotike të përshkuara si më lartë.

*Po ashtu i konfiskohen:*

- mjetet monetare prej **628 € e 20 cent dhe 500 lekë** të Shqipërisë (3x100€ dhe atë Bankënotë prej 100 € me nr. serik: EB1469956725, Bankënotë prej 100 € me nr. serik: UC1052398846, Bankënotë prej 100 € me nr. serik: VA3952421849), (6x50 €, dhe atë Bankënotë prej 50 € me nr. serik: X68494671929, Bankënotë prej 50 € me nr. serik: EC3713898482, Bankënotë prej 50 € me nr. serik: UA9406734249, Bankënotë prej 50 € me nr. serik: WA0785262232, Bankënotë prej 50 € me nr. serik: UB9302542148, Bankënotë prej 50 € me nr. serik: EC0508619033), (1x10€, dhe atë Bankënotë prej 10 € me nr. serik: YA4798339163), (1x5€, dhe atë Bankënotë prej 5 € me nr. serik: VB7991245081), si dhe para të imta në vlerë prej 13 € e 20 cent, ( 3x2€, 4x1€, 4x0.50 cent, 5x0.20 cent, 2x0.10 cent),si dhe (1x500 lekë, dhe atë me Bankënotë prej 500 lekë me nr. serik DB7247201),

- shumën prej **4200 €** (8x200 €, dhe atë me Bankënotë prej 200 € me nr. serik: EA0918287371, Bankënotë prej 200 € me nr. serik: SB7042913716, Bankënotë prej 200 € me nr. serik: UB8038777538, Bankënotë prej 200 € me nr. serik: UC7084717795, Bankënotë prej 200 € me nr. serik: UA8026709655, Bankënotë prej 200 € me nr. serik: UA4041665166, Bankënotë prej 200 € me nr. serik: SA4033444253 dhe Bankënotë prej 200 € me nr. serik: UC5038231024), (11x100 €, dhe atë Bankënotë prej 100 € me nr. serik: N41179475559, Bankënotë prej 100 € me nr. serik: EA5166431884, Bankënotë prej 100 € me nr. serik: EA0403609744, Bankënotë prej 100 € me nr. serik: UC5111008345, Bankënotë prej 100 € me nr. serik: RB2971945031, Bankënotë prej 100 € me nr. serik: X21196248653, Bankënotë prej 100 € me nr. serik: RB3507684953, Bankënotë prej 100 € me nr. serik: EA8565747139, Bankënotë prej 100 € me nr. serik: EA5904700327, Bankënotë prej 100 € me nr. serik: RB4438206833, Bankënotë prej 100 € me nr. serik: EB1620386973), si dhe

- shuma prej **350 €** (4x50 € dhe atë Bankënotë prej 50 € me nr. serik: SD6101556158, Bankënotë prej 50 € me nr. serik: PB3922497199, Bankënotë prej 50 € me nr. serik: RC1330596562, Bankënotë prej 50 € me nr. serik: SA7135156112), (5x20 €, Bankënotë prej 20 € me nr. serik: SB8345714629, Bankënotë prej 20 € me nr. serik: RP0406025604, Bankënotë prej 20 € me nr. serik: UF3478056811, Bankënotë prej 20 € me nr. serik: SB8313312064, Bankënotë prej 20 € me nr. serik: RB0511308572, (3x10€, Bankënotë prej 10 € me nr. serik: UE7327433807, Bankënotë prej 10 € me nr. serik: EB3562515558, Bankënotë prej 10 € me nr. serik: FA4099358367), (4x5 €, Bankënotë prej 5 € me nr. serik: MA4228007915, Bankënotë prej 5 € me nr. serik: YA4542395552, Bankënotë prej 5 € me nr. serik: ND3346229122, Bankënotë prej 5 € me nr. serik: NC3024895778, si mjetë të përfituara përmes kryerjes së veprës penale.

Po ashtu të akuzuarit të lartcekur i konfiskohet: Një telefon mobil i lloji “Iphone X”, ngjyrë e zezë, me IMEI 353054094307469, së bashku me një sim kartel “vala”, i përdorur nga ana e të pandehurit me qëllim të kryerjes së veprës penale, dhe një veturë “. . .”, me trg. 07-948-BN, me nr. shasisë VSX000073P6018188, shfrytëzues A. Sh., pronar D. M., me banim në rrugën “Dërgut Vokshi”, Komuna e Gjakovës, i përdorur me qëllim të kryerjes së veprës penale.

*Të akuzuarit M.XH., i konfiskohen:*

-mjetet monetare prej **657 €, 17 USD, 70 funta angleze dhe 100 franga zviceranë dhe 3000 lekë** R. Shqipërisë (2x100 €, dhe atë Bankënotë prej 100 € me nr. serik: EA7549996384, Bankënotë prej 100 € me nr. serik: RB4610241887), (8x50€, dhe atë Bankënotë prej 50 € me nr. serik:

UD8403021657, Bankënotë prej 50 € me nr. serik: RC2800766047, Bankënotë prej 50 € me nr. serik: SB1490027008, Bankënotë prej 50 € me nr. serik: SD7258790639, Bankënotë prej 50 € me nr. serik: SA6816024014, Bankënotë prej 50 € me nr. serik: UA9466999185, Bankënotë prej 50 € me nr. serik: UA1303208751, Bankënotë prej 50 € me nr. serik: RA2411680704), (2x20€, dhe atë Bankënotë prej 20 € me nr. serik: UA5656366695, Bankënotë prej 20 € me nr. serik: XA4568060133), (1x10€, dhe atë me Bankënotë prej 10 € me nr. serik: VA9409170197), (1x5€ dhe atë me Bankënotë prej 5 € me nr. serik: NC5841281096), (1x2€), (17x1US\$, dhe atë Bankënotë prej 1 dollar me nr. serik: L38674423B, Bankënotë prej 1 dollar me nr. serik: K10735156C, Bankënotë prej 1 dollar me nr. serik: A61382669A, Bankënotë prej 1 dollar me nr. serik: F94938250E, Bankënotë prej 1 dollar me nr. serik: F21604983E, Bankënotë prej 1 dollar me nr. serik: C32292273F, Bankënotë prej 1 dollar me nr. serik: K89053539F, Bankënotë prej 1 dollar me nr. serik: J29824662C, Bankënotë prej 1 dollar me nr. serik: F57191918J, Bankënotë prej 1 dollar me nr. serik: K89494110D, Bankënotë prej 1 dollar me nr. serik: L05245813J, Bankënotë prej 1 dollar me nr. serik: K74870905B, Bankënotë prej 1 dollar me nr. serik: I43449594A, Bankënotë prej 1 dollar me nr. serik: E35516312F, Bankënotë prej 1 dollar me nr. serik: F48009119F, Bankënotë prej 1 dollar me nr. serik: B42367296B, Bankënotë prej 1 dollar me nr. serik: K31467183D), (3x20 funta, dhe atë Bankënotë prej 20 funte me nr. serik: CJ24406693, Bankënotë prej 20 funte me nr. serik: AM88565658, Bankënotë prej 20 funte me nr. serik: HE69553693), ( 1x10 funta, dhe atë Bankënotë prej 10 funte me nr. serik: CE34484354), (1x50 franga, dhe atë Bankënotë prej 50 frang me nr. serik: 15K5659950), (2x20 franga, dhe atë Bankënotë prej 20 frang me nr. serik: 15S7400557, Bankënotë prej 20 frang me nr. serik: 16H7410441), (1x10 franga zviceranë, dhe atë Bankënotë prej 10 frang me nr. serik: 16L1291917), (1x2000 lekë, dhe atë Bankënotë prej 2000 lekë me nr. serik: QZ226891), (1x1000 lekë, dhe atë Bankënotë prej 1000 lekë me nr. serik: GA8521314), dhe para të imta në vlerë prej 2 €, si mjetë të përfituara përmes kryerjes së veprës penale.

Po ashtu të pandehurit M.XH., i konfiskohet edhe: **një telefon** mobil i llojit “Iphone 7 plus”, ngjyrë e zezë, së bashku me sim kartel me nr. . . . , i përdorur nga ana e të pandehurit me qëllim të kryerjes së veprës penale dhe **një veturë** “. . .”, ngjyrë e gjelbër, me trg.01-564-MR, me nr. Shasisë UU1LSD4AH34634469, shfrytëzues M.XH., me pronar M.B.,ga Prishtina, rruga “. . .” ob.35/23, i përdorur me qëllim të kryerjes së veprës penale, dhe një çelës i veturës.

Urdhërohet Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, të shesë, likuidoj ose të mbajë pasurinë e luajtshme të cekur më lartë.

Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi Urdhërohet kthimi i telefonit mobil i llojit “Iphone”, ngjyrë e zezë, me sim kartelën . . . , pronë e dëshmitarit M.G., nga Gjakova, rruga ... nr. 40, si dhe automjeti i markës “. . .”, ngjyrë hiri, me targa ...-.. . , numri i shasisë: WFOAXXGCDAXS10520, me pronar: M.B., numri personal: . . . , banues në fshatin R., Komuna e Gjakovës, së bashku me qelës të automjetit si dhe certifikata e regjistrimit të automjetit me nr. CRA 1829529, meqenëse gjatë kësaj procedure nuk është vërtetuar se janë shfrytëzuar si mjete për kryerjen e veprës penale.

Obligohen të akuzuarit që, secili veç e veç, ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale dhe atë:  
- në emër të paushallit gjyqësor, secili, shumën prej njëqind (100) €, si dhe  
- për kompensimin e viktimave të krimit, secili, shumën prej pesëdhjetë (50) €, të gjitha këto në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## A r s y e t i m

### *1. Pjesa hyrëse e arsyetimit të aktgjykimit*

Prokuroria Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP/I.nr.04/2022 të datës 25.07.2022, ndaj të akuzuarve A.SH., dhe M.XH., secilin veç e veç, për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 2, të KPRK-së dhe të njëjtën e ka dorëzuar në gjykatë me datë 25.07.2022.

Me kërkesën e të pandehurit M.XH., është përjashtuar Prokuroria Themelore e Gjakovës dhe lënda i është bartur Prokurorisë Themelore në Prizren-Prokurores së Shtetit Ervehe Gashi.

### *1.a. Kompetenca*

Gjykata Themelore në Gjakovë duke u bazuar në Ligjin për Gjykatat, saktësisht në nenin 19 par.1, e lidhur me nenin 22 të Kodit të Procedurës Penale, vlerëson se ka kompetencë lëndore dhe territoriale për ta trajtuar këtë rast penal.

Bazuar në aktakuzën e ngritur, veprat e pretenduara penale kanë ndodhur në Komunën e Gjakovës, ashtu që sipas nenit 22 par.1 nënpar.1.1 të KPP-së, veprat penale që konsiderohen krime të rënda për qëllime të këtij Kodi, ndër të tjera janë veprat penale të dënueshme me mbi dhjetë (10) vjet burgim, ashtu që në ndërlidhje me nenin 19 par.1 të Ligjit për Gjykatat, veprat penale të dënueshme mbi dhjetë (10) vjet, bijnë në juridiksionin e Departamentit për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore, andaj meqë për veprën penale nga neni 267 par.2 të KPRK-së, parashihet dënim me burgim prej dy (2) deri në dymbëdhjetë (12) vjet, lënda është gjykuar në Gjykatën Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda.

### *1.b. Shqyrtimi gjyqësor*

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancat e shqyrtimit gjyqësor me datë 15.12.2022, 08.02.2023, 24.03.2023, 28.04.2023, 20.06.2023, 04.08.2023, 16.11.2023, 13.02.2024 dhe 05.03.2024, të cilat janë mbajtur në prezencën e Prokurores së Shtetit Ervehe Gashi, të akuzuarit A.SH., dhe mbrojtësit të tij, av. Meshari Selimaj, me seli në Gjakovë, si dhe të akuzuarit M.XH., dhe mbrojtësit të tij, av. Korab Bokshi, me seli në Gjakovë.

### *1.c. Publiciteti dhe regjistrimi i seancave të shqyrtimit gjyqësor*

Të gjitha seancat e shqyrtimit gjyqësor në këtë rast kanë qenë publike.

Seancat e shqyrtimit gjyqësor nuk janë regjistruar me audio dhe video në mungesë të pajisjeve të nevojshme për incizime të tilla, mirëpo regjistrimi është bërë vetëm në procesverbal me shkrim. Palët nuk kanë pasur vërejtje në përmbajtjet e procesverbaleve. Pas çdo seance të përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, palëve u është dhënë nga një kopje e procesverbalit.

## *2. Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimit gjyqësor*

Prokurorja e shtetit edhe pas leximit dhe analizimit të aktakuzës PP/I.nr.04/22 të datës 25.07.2022, ka qëndruar në tërësi pranë saj.

I akuzuari A.SH., pas konsultimit me mbrojtësin e tij, duke u deklaruar lidhur me fajësinë, ka theksuar se: e ka pranuar fajësinë edhe në polici, dhe në prokurori, lidhur me posedimin e narkotikut, por e pranon fajësinë me paragrafin 1 e jo sipas paragrafit 2, ashtu sikurse akuzohet nga Prokuroria, po ashtu ka theksuar se veprën penale e ka kryer vetë dhe nuk ka pasur bashkëpunim me këtu të pandehurin e dytë M.XH., .

I akuzuari M.XH., pas konsultimit me mbrojtësin e tij, duke u deklaruar lidhur me fajësinë, ka theksuar se nuk e ndien vetën fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet.

### *2.a. Fjala hyrëse*

*2.a.1.* Prokurori i Shtetit, ka konsideruar se nga të gjitha provat materiale dhe ato personale që do të administrohen gjatë shqyrtimit kryesor, me pa mëdyshje përtej dyshimit të bazuar do të vërtetohet teza e aktakuzës, se këtu të akuzuarit A.SH. e M.XH., kanë kryer veprat penale të përshkruara më afërsisht në pikën I dhe II të dispozitivit të aktakuzës.

*2.a.2.* Mbrojtësi i të akuzuarit A.SH., , av. Meshari Selimaj, në fjalën hyrëse, ka deklaruar se bazuar në deklaratimet e bëra të të mbrojturit, që nga fillimi i kësaj procedure penale në prokurori, më pas dhe në gjykatë vazhdojnë të qëndrojnë pranë argumenteve të tyre se veprimet e kundërligjshme të kryera nga i pandehuri A., nuk përbëjnë ato veprime inkriminuese të cilat prokuroria i ka kualifikuar sipas parag. 2 të nenit 267 të KPRK-së, mbi këtë bazë në tërësi kemi të bëjmë me parag. 1 të veprës në fjalë, kështu që dispozitivi i aktakuzës ka shpërputhje me provat të cilat i mbështet aktakuza gjegjësisht përshkrimin faktik-juridik e sidomos kur citohet kur i pandehuri A.... prej disa muaj është marrë me shitjen e substancave narkotike personave të ndryshëm në qytetin e Gjakovës, fshatrave të komunës së saj dhe më gjerë dhe siç shihet një përshkrim i tillë përbënë një përshkrim të pa definuar dhe i hamendësuar nga prokuroria nga se të njëjtit nuk kanë mund ta vërtetojnë cilët janë ata persona të ndryshëm të cilëve ju është shitur narkotiku, pastaj cilat janë ato fshatra të komunës së Gjakovës, ku është shitur narkotiku apo fraza e përmendur “edhe më gjerë”, shtrohet pyetja çka nënkuptohet me këtë edhe më gjerë dhe në këtë mënyrë prokuroria po ngrit hipoteza dhe në vend që ta akuzojë të pandehurin konform provave materiale me kualifikimin juridik të duhur, dhe kjo përbënë shkelje të nenit 48 të KPPRK-së. Meqenëse prokuroria ka për detyrim që ti nxjerr të gjitha rrethanat e aspektit të pranimit të fajësisë apo pafajësisë dhe kualifikimin juridik të ja përshtatë provave materiale dhe jo ta akuzojë dikend më rëndë se sa që duhet. Para cilësimit të tillë juridik prokuroria është dashur

që ti vërtetojë të gjitha rrethanat e rastit e të cilat janë sasia e narkotikut, rrethanat se i pandehuri a është dënuar më parë për shitjen e narkotikut, sepse i njëjti asnjëherë nuk është dënuar, sasia e narkotikut të konfiskuar në peshë prej 87,59 gram, ndonëse e kundërligjshme dhe një veprim i tillë i të njëjtit i pa pranueshëm, me asnjë provë nuk vërtetohet se i pandehuri e ka destinuar atë sasi për transport, dorëzim, ndërmjetësim, dërgim, apo dërgimit në transit, por janë provat materiale që argumentojnë posedimin e narkotikut për qëllim të shitjes bazuar edhe në sasinë e narkotikut të gjetur. Për më tej dërgimi apo dërgimi në transit i atribuohet çdo dërgese të një sasive të drogës me qëllim të shitjes, shpërndarjes apo ofrimit për shitje te personi tjetër qoftë edhe përmes personit fizik apo juridik ku si cak është udhëtimi prej një vendi në një vend tjetër marrim shembull dërgesat e narkotikut ndërkufitare nga një vend në një vend tjetër. Përveç provave materiale edhe nga provat personale nuk vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale nga par. 2 i nenit në fjalë, askush prej dëshmitarëve nuk thotë se e ka blerë narkotikun në mënyrë direkte apo indirekte dhe sidomos dy prej dëshmitarëve nuk thonë fare se kanë blerë narkotik nga i pandehuri A...Para një situatë të tillë nuk ekziston ky cilësim juridik dhe në qoftë se prokuroria bënë një lëvizje në kuptim të ndryshimit të këtij kualifikimi ligjor e të cilin edhe e ka obligim sipas nenit 48 të KPPRK-së, atëherë i pandehuri do të deklarohet për fajësinë dhe do ta pranojë fajësinë për veprën penale nga neni 267 par. 1 të KPRK-së.

2.a.3. I akuzuari A.SH., , në fjalën hyrëse, ka deklaruar se: pajtohet me deklarin e mbrojtësit të tij dhe nuk ka asgjë për të shtuar.

2.a.4. Mbrojtësi i të akuzuarit M.XH., , av. Korab Bokshi, në fjalën hyrëse, ka deklaruar se gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor kemi të njohur faktin se para vetës kemi një aktakuzë ku i akuzuari M... ngarkohet nga prokuroria se ka kryer veprën penale nga neni 267 par. 2 të KPRK-së. Prokuroria në këtë çështje ka propozuar një mori provash materiale dhe personale që do të shqyrtohen gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, e që mendojmë si mbrojtje se pikërisht me administrimin e këtyre provave të propozuara nga prokuroria gjykata do të nxjerr një përfundim krejt tjetër nga ajo të cilën e ka vlerësuar prokuroria, mendojmë pikërisht me prova materiale dhe personale të propozuara nga prokuroria e vetmja lidhje e të akuzuarit M... me këtë çështje është se është shoku i të akuzuarit A., i cili nuk e ka mohuar një pjesë të veprimeve faktike. I ka propozuar gjykatës që të bëjë vlerësimin e ligjshmërisë së dëshmitarit M.G., deklaratë e cila nuk mund të administrohet si provë në shqyrtimin gjyqësor për shkak se dëshmitari M... në këtë çështje ka qenë i bashkëpandehur dhe në kuptim të nenit 123 par. 5 i KPPK-së, çfarëdo deklaratë e dhënë nga të bashkëpandehurit nuk mund të përdoret si provë në raport me të bashkëpandehurit tjerë.

2.a.5. I akuzuari M.XH., në fjalën hyrëse, ka deklaruar se: pajtohet me deklarin e mbrojtësit të tij dhe nuk ka asgjë për të shtuar.

## 2.b. Provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor

Meqenëse të akuzuarit nuk e kanë pranuar fajësinë dhe atë secili veç e veç për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 2 të KPRK-së, gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike, në seancat e shqyrtimit gjyqësor në cilësi të dëshmitarëve ka dëgjuar dëshmitarët: D.T., M.G.,



E.K., A.B., E.T., M.XH., Ç.ZH., V.L., si dhe ka bërë leximin dhe administrimin e provave materiale, siç janë:

- raporti i Oficerit H.S., i dt.03.03.2022;
- raporti i Oficerit SH,S, i dt.03.03.2022;
- raporti plotësues i dt.23.03.2022;
- vërtetimet mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i dt.03.03.2022;
- procesverbali për kontroll dhe sekuestrim të përkohshëm i dt.03.03.2022;
- raporti nga ekspertiza për ekzaminimin e telefonave e datës 26.06.2022;
- raporti i ekspertimit për ekzaminimin e narkotikut AKF/2022-1580/2022-1528 dt.30.05.2022;
- informata lidhur me zbatimin e urdhëresës verbale për bastisje, i dt.01/03.05.2022;
- raporti informues 15 ditor mbi zbatimin e masave të fshehta, dt.02.02.2022 dhe 15.02.2022;
- CD-të, tre copë, si dhe
- Foto dokumentacioni dhe shkresat tjera në lëndë.

## 2.c. Deklaratat e dëshmitarëve

2.c.1. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 08.02.2023, në cilësi të dëshmitarit është dëgjuar dëshmitari A.B., me ç'rast i njëjti duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e prokurorit të shtetit, ka deklaruar se qëndron pranë deklaratës së dhënë në prokurori. I kujtohet se me datë dt.03.02.2022, diku në orët e hershme të mëngjesit, është takuar me A....Sh...përveç kësaj ka deklaruar se është takuar shumë herë rastësisht se janë afër me shtëpi, kanë qenë në gjendje të dehur në shumicën e rasteve, kanë biseduar tema të ndryshme, ka ndodh që e kanë ndërruar ndonjë cigare, ka pasur momente që ka qenë vetëm A..., por ka pasur momente që ka qenë edhe me të tjerë por nuk i ka njohur, duke pasur parasysh natyrën edhe të A..., i cili bënë humor, e në shumicën e rasteve edhe i ka nguc personat që i ka pasur në kerr, duke ia bërë me mimikë që me e vazhdua humorin, e ka cekur edhe në prokurori se i ka përdor disa terma si emra të parfumeve, orizit etj., por gjithmonë është munduar me iu përshtat humorit të A.... Më tej, ka shtuar se po atë ditë, rreth orës 04:42/h, pasi që kohë pas kohe kanë luajtur bastore, me atë program që e ka pasur A... na e ka kryer atë shërbim, dhe ky ka qenë rasti që i ka kërkuar lojërat me na i krijua A.. prej Mitrovicës, por kur është kthyer prej Mitrovicës ia ka gjuajtur të hollat. Më tutje ka shtuar se me A....njihet qysh para luftës, por e njeh edhe babain e tij-H....që ka kryer punë në shtëpinë e tij si ujësjellës, por edhe A.. për 7-8 herë ka kryer punë në shtëpinë e tij. Gjersa, M... e njeh nga koha kur ka punuar në restorantin "...", ku ka punuar si kamarier

ndërsa M. kuzhinier, viti nuk i kujtohet por kjo ka qenë në fillim kur është hapur restoranti. Nuk i kujtohet se për çfarë malli ka biseduar me A...me datë 01.02.2022, në ora 21,33/h.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.SH., av. Meshari Selimaj dhe i akuzuari nuk kanë parashtruar pyetje për dëshmitarin.

Mbrojtësi i të akuzuarit M.XH., av. Korab Bokshi dhe i akuzuari nuk kanë parashtruar pyetje për dëshmitarin.

*Në pyetjet e gjykatës*, dëshmitari ka deklaruar se mbetet pranë deklaratës së dhënë në prokurori me dt.27.04.2022, në pjesën ku ka deklaruar se “A... i ka treguar se i ka 1 kg, mall-kokainë të fshehur në tokë”, edhe në gjykatë e ka dhënë të njëjtën përgjigje, ka theksuar se me A...kanë qenë në gjendje të dehur dhe kjo ka qenë pjesë e humorit për të cilin kanë bërë humor në kerr. Në momentin kur i kanë thënë këto fjalë vetura ka qenë e ndalur, A... ka qenë në veturë ndërsa, dëshmitari ka qenë jashtë veturës, e kanë ndezur nga një cigare dhe gjatë kësaj kohe e kanë bërë këtë bisedë të çastit, derisa i kanë përfunduar cigaret e më pas janë ndarë secili nëpër shtëpitë e veta. Me sa i kujtohet kerri ka qenë i ndalur, ai ka qenë jashtë kerrit, ndërsa, A... ka qenë në kerr së bashku me dy persona të tjerë dhe e ka dëgjuar bisedën derisa A... me shikim ka qenë kah unë, më është drejtuar por, bisedën e ka bërë me qëllim që ta dëgjojnë ata dy persona. Pra, edhe njëherë thekson se A... bisedën më shumë e ka pasur për ata dy persona të cilët kanë qenë në kerr, por, me pamje i është drejtuar atij, pasi që ka qenë jashtë kerrit afër dritares së shoferit, saktësisht afër dritares ku ishte i ulur A..., por, ka qenë në gjendje të dehur. Faktin se ka qenë i dehur e ka thënë edhe në Prokurori kur ka deklaruar.

*2.c.2. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 20.06.2023, në cilësi të dëshmitarit është dëgjuar V.L., me ç’rast i njëjti duke i u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e prokurorit të shtetit*, ka deklaruar se A... e njuh prej familjes prej babit, më herët nuk e ka njohur A... Me A.. ka pasur raporte të mira, por nuk është takuar shumë shpesh me të, në fakt nuk është takuar hiq, i ka shkruar për me u takuar por nuk është takuar me A... Arsyeja që i ka shkruar atij, është sepse ka dashur për me e pyet për një punë, pasi që në atë kohë ka qenë i papunë. Ka kërkuar me u takuar me të në çarshi të vogël të kafiteria “...”, por nuk është takuar me të. Me tej ka shtuar se A... ka dashtë për me e pyet për me punua në Kazakistan. Gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se nuk ka blerë nga A.SH., ndonjëherë substancë narkotike të llojit kokainë edhe pse në fakt ka thënë se e ka blerë, e këtë e ka thënë në polici dhe prokurori, këtë deklaram e ka thënë sepse ka pasur një stresë-ngarkesë, pra, e ka pasur një rast, dhe ka qenë shumë i ngarkuar psikikisht në ato momente atëherë , pasi që e ka pasur një rast personal në gjykatë dhe polici, ku ia kanë nxënë disa lëndë narkotike – marihuanë. Ndërsa kur është pyetur se “ju në deklaratën tuaj në polici keni treguar se keni kërkuar nga A. SH., që të takoheni me dt.11.11.2021 tek “Rod House” dhe e keni kontaktuar të njëjtin nëpërmes aplikacionit instagram, ndërsa, gjatë ekzaminimit të telefonit rezulton se me të vërtetë e keni kontaktuar të njëjtin dhe po ashtu keni deklaruar se jeni konsumues i narkotikut dhe arsyeja e kontaktit ka qenë furnizimi me narkotik, a na tregon çfarë narkotiku ke qenë duke konsumuar në atë kohe”, i njëjti ka deklaruar se ka konsumuar narkotik të llojit marihuanë, por nuk konsumon më. Kokainën e ka konsumuar, por më nuk e konsumon. M.XH., e njuh si figurë, por kontakt nuk ka pasur me të.

*Në pyetjet e mbrojtësit të të akuzuarit A.SH., av. Meshari Selimaj, dëshmitari ka deklaruar se në polici është intervistuar në cilësi të dëshmitarit dhe të njëjtën ditë nuk ka pasur telefon me veti. Telefonin e ka pasur në polici ndoshta një javë para se të intervistohet.*

I akuzuari A.SH., nuk ka parashtruar pyetje për dëshmitarin.

Mbrojtësi i të akuzuarit M.XH., av. Korab Bokshi dhe i akuzuari nuk kanë parashtruar pyetje për dëshmitarin.

2.c.3. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 20.06.2023, është dëgjuar dëshmitari Ç.SH., me ç'rast i njëjti duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e prokurorit të shtetit, ka deklaruar se mbetet pranë deklaratave të dhëna në polici dhe prokurori. Ka shtuar se A.SH., në vijë ajrore e ka rreth 1000 metra larg, e din se punon me ujë, ka pasur kontakt me të, po mendon përshëndetje me njeri tjetrin dhe ende vazhdojnë të përshëndetën me njëri tjetrin, por kontakte nëpërmjet rrjeteve sociale apo përmes telefonit nuk kanë. Dëshmitaren M... Xh...i e cila e ka nofken M... e njeh, dhe me të është takuar në shkurt të vitit 2022 në villa, "...” në Piskotë, dhoma nuk i kujtohet. Ka deklaruar se nuk është konsumues i narkotikëve sepse e ka lënë. Në kohën kur ka qenë me M..., pra në muajin Shkurt 2022, nuk ka përdorur substanca narkotike, pra atë ditë derisa ka qenë me ta, nuk e ka përdorur, dhe atë ditë në dhomë nuk ka qenë askush tjetër përveç tij dhe M...sa ka qenë me të nuk ka porositur kokainë në sy të tij, jo, mirëpo telefonin nuk ia ka kontrolluar. Është takuar në villën "...” me Makfireten, ku prezent ka qenë edhe E... H..Z.G., dhe M..., ka qenë orë policore, sa e mban mend nuk kanë pasur ku të rrijnë, dhe kanë shkuar në villa. Atë natë nuk e dinë se a ka porositur ndokush nga ta kokainë, pasi që dëshmitari ka qenë nën ndikim të alkoolit dhe ka flejt në gjumë. Ka deklaruar se nga A.SH., asnjëherë nuk ka blerë substanca narkotike. Ndërsa kur është pyetur nga prokurorja se ju sapo deklaruat se asnjëherë nuk keni blerë nga këtu i akuzuari A. Sh., substancë narkotike të llojit kokainë, ndërsa, në deklaratën tuaj të dhënë në polici me dt.20.03.2022, në faqen e fundit keni pohuar se nuk keni konsumuar narkotik, po ashtu, keni pohuar se keni qenë duke fjet gjumë dhe jeni zgjuar në mëngjes, por në pyetjen e parashtruar se sa herë keni blerë kokainë nga A.i jeni përgjigjur që keni blerë disa herë doza të vogla kryesisht 0.2 gr, 0.3 gr, i njëjti ka deklaruar se e vërteta është kjo që e thash sot, pasi që kur e ka thënë këtë ka qenë i ndaluar në polici për 48 orë.

*Duke u përgjigjur në pyetjet e parashtruara nga mbrojtësi i të akuzuarit A.SH., av. Meshari Selimaj, dëshmitari ka deklaruar se pasi që është intervistuar nga policia e ka lexuar dhe më pas e ka nënshkruar deklaratën. Ka theksuar se në pjesën ku ka deklaruar se “nga A.i, ka blerë 0.2gr, dhe 0.3 gr kokainë”, ashtu ka deklaruar sepse i është bërë presion nga policia. I njëjti ka shtuar se mbetet pranë deklaratës së dhënë në Prokurori.*

I akuzuari A.SH., nuk ka parashtruar pyetje për dëshmitarin.

Mbrojtësi i të akuzuarit M.XH., av. Korab Bokshi dhe i akuzuari nuk kanë parashtruar pyetje për dëshmitarin.

2.c.4. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 04.08.2023, është dëgjuar dëshmitarja E.S-T., me ç'rast e njëjta duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e

*prokurorit të shtetit*, ka deklaruar se nuk i kujtohet asgjë çka ka deklaruar në polici dhe prokurori pasi që ka qenë nën ndikim të hapave, ka qenë paciente e F.A., dhe I.G., si dhe ka qenë nën depresion të shkallës së lartë. Për çështjen e konsumimit të ilaçeve, nuk e din se a e ka njoftuar prokuroren e çështjes dhe zyrtarin hetues policor pasi që ka qenë nën ndikim të terapisë dhe ka përzier edhe ilaçe tjera, raportin mjekësor nuk e ka pasur me veti në gjykatë mirëpo ka deklaruar se mund ta sjell atë. M.Xh., ka punuar të lokali “G...a” kuzhinier, ku edhe tani punon dhe ky lokal gjendet në lagje në afërsi të banesës së tij. Substanca narkotike nuk ka blerë asnjëherë nga M.XH., e as nga A.SH., Dëshmitarja duke u ballafaquar me deklaratën e dhënë në polici dhe prokurori ku ka deklaruar se “i njuh këta dytë dhe ka blerë substanca narkotike nga ata, ndërsa, në gjykatë ka deklaruar se nuk është përdoruese, nuk ka blerë substanca narkotike as nga M. e as nga A.i”, e njëjta ka sqaruar se nuk ka blerë substanca narkotike e as nuk ka qenë përdoruese e drogës, kjo është e vërteta e këtë e thotë pasi që tani është e kthjelltë, dhe nuk është nën ndikimin e terapisë. Me tej ka deklaruar se nuk është në dijeni se çfarë veture ka M.XH., e as A.SH.,. Në polici dhe në prokurori ke dhënë një deklaratë të tillë pasi që nuk ka qenë vetvetja, sepse nuk e dinë çka ka deklaruar pasi që ka qenë nën ndikimin e terapisë. Prokurori i shtetit ka kërkuar nga trupi gjykues që ta obligojë dëshmitaren q ti sjellë të gjitha raportet mjekësore së bashku me rekomandimet e tyre për periudhën kohore nga muaji 01.03.2022, e deri me dt.01.08.2022, këtë e kërkon nga fakti se askund në shkresat e lëndës as në polici e as në prokurori nuk është evidentuar se dëshmitarja është marr në pyetje në gjendje depressive dhe nën ndikimin e medikamenteve që mund të jenë antidepresant që mund të ndikojnë në kujtesën dhe në të gjykuarit e këtu dëshmitares. Nuk shoh askund që dëshmitarja ka treguar për gjendjen e saj ose që nga hetuesit policor ose prokurori i çështjes është pyetur, pra, nuk është vërejtur që e njëjta vuan nga një gjendje e tillë.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.SH., , av, Visar Perlaskaj, nuk ka parashtruar pyetje për dëshmitaren. I akuzuari A.SH., nuk ka parashtruar pyetje për dëshmitaren. Mbrojtësi i të akuzuarit M.XH.,, av. Korab Bokshi, nuk ka parashtruar pyetje për dëshmitaren. I akuzuari M.XH., nuk ka parashtruar pyetje për dëshmitaren.

2.c.5. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 04.08.2023, është dëgjuar dëshmitari M.G., me ç’rast i njëjti duke i’u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e *prokurorit të shtetit*, ka deklaruar se A.SH., e njuh qe 5 vite, punon si ujësjellës, prej qebaptores te “...” ku ka punuar si kamerier, ka qenë klienti i tyre i qebaptores. Ka pasur shoqëri dhe ka ndejtë shumë rrallë. Gjatë vitit 2022 respektivisht në periudhën kohore Janar, Mars/2022.

Me A.. ka ndejt kryesisht pas orës 02,00/h, të natës kur e ka përfunduar punën, kanë bërë ndonjë xhiro. M... e njuh sepse kanë punuar kuzhinier dhe e kanë të njëjtin zanat. A....dhe M... i ka parë duke ndejtë bashkë me njëri tjetrin por i ka parë shumë rrallë. Në kohën kur ka bërë xhiro me A.... ka bërë me një veturë “....” dhe ajo ka qenë e A.. t. I pyetur nga prokurori se ju deklaruat se keni bërë xhiro me A....e unë t’ ju njoftoi se ndaj tij me masa të fshehta të aprovuara nga Gjykata është bërë përgjimi ambiental, me dt.31.02.2022 rreth orës 22,11/h, derisa është zbatuar përgjimi ambiental, në automjetin e A.... keni qenë ju dhe është zhvilluar biseda ku A.SH., ju është drejtuar me fjalët: ”gjatë arrestit shtëpiak gjatë gjithë natës ka shitur kokainë deri në ora 07,00/h, të mëngjesit dhe prej orës 03,00/h deri në orën 05,00/h të mëngjesit i fitoi nga 500.-€, dhe ka vazhduar që më vonë mandej në punën pasdite prej orës 15,00/h deri në orën 01,00/h, në

qebaptoren “...” në Gjakovë, a keni parë, a ka shitur A. Sh. kokainë në prezencën tuaj? Dëshmitari: derisa ka qenë me mua jo, sepse unë orarin e punës e kam pasur prej orës 16,00/h, deri në ora 02.00/h, pas mesnate, vetëm ditën e Enjte ka pasur pushim. Gjatë muajit Shkurt të vitit 2022, ka qenë në shoqëri me A.SH., dhe M.XH., në veturën e A..., e pikërisht në orët e mbrëmjes, ka qenë atë natë kur ka ndodhur rasti, por nuk ka qenë çdo natë, ndoshta ka mundur me ndodhë njëherë apo dy gjatë këtij muaji. Natën kur është arrestuar A.i ka qenë prezent respektivisht ka qenë në shoqëri me të, por nuk ka qenë në ngjarje se ku ka qenë duke shkuar A.... Kanë qenë me automjetin . . . Me tutje ka deklaruar se ka qenë duke shkuar në shtëpi atë natë dhe vendin e punës e ka larg shtëpisë rreth 3 km.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.SH., av, Meshari Selimaj dhe i akuzuari nuk kanë parashtruar pyetje për dëshmitarin.

Mbrojtësi i të akuzuarit M.XH., av. Korab Bokshi dhe i akuzuari nuk kanë parashtruar pyetje për dëshmitarin.

2.c.6. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 04.08.2023, është dëgjuar dëshmitari E.K., me ç’rast i njëjti duke i’u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e prokurorit të shtetit, ka deklaruar se asnjëherë nuk ka qenë përdorues i narkotikëve. D.T.,e njej pasi që jetojnë në një lagje. Lidhur me pjesën ku është pyetur nga Prokurori se tek pompa e derivateve HIB shihet se dhe ju keni qenë prezent së bashku me D.. në kohën kur D... ka vendosur një qese të vogël narkotikut në tavolinë, i njëjti ka sqaruar se ka qenë në tavolinë në pompën HIB, ai (D..) çka ka vepruar nuk e dinë, ka qenë i ulur në tavolinë rreth një orë dhe nuk ka pasur kontakt me De..., dhe me ta ka qenë edhe një shoqe quhet A.E., dhe gjatë tërë kohës nuk ka qëndruar D.... në tavolinë me ta. D.. një qese e ka lënë në tavolinë, por është larguar direkt dhe ka shkuar siç i ka thënë në Xërxë pra, ai e ka lënë një qese të zezë, të thatë në tavolinë dhe nuk e ka parë që e ka marr, unë kam qenë në HIB me shopen, ai ka kërkuar telefon nga unë, një telefon ja ka dhënë shoqja A..., sepse nuk kisha telefon. Qesen e ka marr dhe e ka këqyr çka ka dhe e ka lënë në banjë sepse ka qenë e thatë. A.SH., dhe M.XH., personalisht nuk e njej asnjërin, A.in për herë të parë e ka takuar në Gjykatë, ndërsa, M. nuk e njej, e as nuk e dinë kush është. Duke u ballafaquar me deklaratën e dhënë në prokurori lidhur me pjesën kur ka deklaruar se ka qenë me parë konsumues i narkotikëve mirëpo tash nuk është më, i njëjti ka sqaruar se e vërteta është se e ka përdorur një ose dy herë marihuanë, por, tani nuk është përdorues. Duke u pyetur nga prokurori se në pyetjen time deklaruar se D... ka sjell me vetë një najlon, të cilin e ka lënë në tavolinën tuaj, najloni ka qenë i zbrazët dhe ju atë pastaj e keni fsheh në banjo, ndërsa, në pyetjen e prokurorit në cilësinë e dëshmitarit jeni përgjigjur se është e vërtetë se ka dal D..., është takuar me dikë jashtë....-it, ka sjellë pastaj një qese të vogël me narkotik e ka lënë aty në tavolinë ku isha unë me një shoqe A.E., nga Prishtina, D... tha unë po shkoi në Xërxë, ndërsa, unë meqenëse, ai u vonua dy orë, e kam fshehur prapa shportës së mbeturinave në banjo që kur të vijë D...të vijë e të e marr, cila është e vërtetë? I njëjti ka sqaruar se e vërteta është se qesja ka qenë e thatë dhe këtë e mban mend shumë mirë. Ka shtuar se A..... e njej nga fëmijëria, por për herë të parë që është takuar me A... është në gjykatë.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.SH., av, Meshari Selimaj dhe i akuzuari nuk kanë parashtruar pyetje për dëshmitarin.

Mbrojtësi i të akuzuarit M.XH., av. Korab Bokshi dhe i akuzuari nuk kanë parashtruar pyetje për dëshmitarin.

2.c.7. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 16.11.2023, është dëgjuar dëshmitarja M.XH., me ç'rast e njëjta duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e prokurorit të shtetit, ka deklaruar se nuk i kujtohet mirë se çka ka deklaruar në polici dhe prokurori. Ka deklaruar se me datë 20.02.2022, ka qenë në motelin “...” që ndodhet në fsh. ..., ka qenë me Ç...në dhomë si shok, pastaj A... as nuk e ka parë, as nuk e njeh, telefonin e saj e ka përdorur Ç, çka ka shkruar me A.. nuk dinë, dhe kur e ka dhënë deklaratën në polici aty iu ka thënë po shkojë të marr telefonin tim dhe ju shikoni bisedën se çka ka fol Ç... me A., sepse nuk e ka parë çka kanë fol ata në mes veti, sepse gjatë kësaj kohe ka qenë në banjo duke bërë dush. Kur e ka dhënë deklaratën ka qenë një muaj - një muaj e gjysmë para lindjes, ose më pak dhe kur e ka dhënë deklaratën ka qenë në gjendje me thënë po, çka do që të i thonë sepse ka qenë në gjendje psikike, e stresuar para lindjes. Duke u pyetur nga prokurorja se atë ditë a ka sjell dikush substancë narkotike të llojit kokainë në dhomën apo në villen tuaj ku ju keni qenë, e njëjta ka sqaruar se ka qenë e stresuar, para lindjes ka dashur ta kryej deklaratën më shpejt, por, bisedën në telefon e ka bërë Ç.. e jo ajo. E ka dëgjuar Ç... që ka thënë se po vjen A., por, çka ka sjell nuk e dinë se sikurse ka thënë edhe me herët ka qenë në banjo. Më tej ka deklaruar se nuk e dinë a ka paguar Ç.. kokainë, por e dinë se në dhomë nuk e ka përdorur kokainën në praninë e saj, a ka hyrë në banjo, apo dikund tjetër nuk e dinë. Me datë 27.02.2022, ka qëndruar në motelin “... dhe ka qenë Ç..., E., një person tjetër i Prishtinës, emrin nuk ia dinë dhe ata persona në praninë e saj nuk kanë përdorur substanca narkotike, Ç.. nuk e dinë kë e ka thirr, por, i kujtohet se ka thirr me emrin .... dhe i ka thënë thirre A..Por, shton se A... asnjëherë nuk e ka parë, as dorën nuk ia ka dhënë, vetëm si emër e ka dëgjuar kur Çlirimi ka fol përmes telefonit të saj, dhe personi me emrin D... nuk ka sjellë ndonjë gjë në dhomë, dhe të njëjtin nuk e ka parë kurrë. Pasi është ballafaquar me deklaratën e dhënë në polici ku e njëjta ka deklaruar se lidhur me bisedat telefonike që i ka kryer Ç..., nëpërmes telefonit të saj, ndër të tjera ka deklaruar se ndërkohë sa ishin brenda dhomës, Ç.... ka pasur me vete edhe narkotikë të llojit kokainë, pasi që e ka konsumuar sasinë që e kishte me vete, ai i ka kërkuar telefonin e saj edhe e ka thirrur personin e quajtur A... Sh..., nga i cili ka kërkuar që në motel “...”, t'i sjellë tri doza me kokainë, dhe është pyetur se a është e vërtetë kjo, dëshmitarja ka deklaruar se nuk e dinë, nuk i kujtohet aq mirë. Ndërsa, kur është ballafaquar me pjesën kur e njëjta ka deklaruar se atë ditë a e ka parë A.SH., kur ai ka sjellë kokainë, ajo është përgjigjur se po, ka sjellë tre doza me kokainë, po i ka parë, dhe që A...SH., ka qenë me një automjet “pick up”, me ngjyrë të bardhë, e pyetur se a është e vërtetë kjo deklaratë, dëshmitarja ka deklaruar se, ka qenë me pick up, është e vërtetë, ndërsa, për shumicën e sendeve tjera, nuk i mban mend. E pyetur se sot deklaroi se nuk din e çka ka ndodh lidhur me sjelljen e narkotikut dhe pagesën brenda dhomës se motel “Molika”, ndërsa, në polici në detaje ka treguar se çka ka ndodhur, dhe nuk keni përmendur se keni qenë në banjo, ashtu si deklaruat në seancë, se cila është e vërteta, atë që ka deklaruat në polici, dhe prokurori, apo atë që e deklaruat në shqyrtim gjyqësor, dëshmitarja ka deklaruar se nuk dinë, nuk i kujtohet asgjë, e vërteta është kjo qe ka deklaruar sot në shqyrtim gjyqësor.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.SH., , av. Meshari Selimaj, dhe i akuzuari nuk kanë parashtruar pyetje për dëshmitaren.

Mbrojtësi i të akuzuarit M.XH., av. Korab Bokshi, dhe i akuzuari nuk kanë parashtruar pyetje për dëshmitaren.

2.c.8. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 13.02.2024, është dëgjuar dëshmitari D.T., me ç'rast i njëjti duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e prokurorit të shtetit, ka deklaruar se me datë 28.02.2022, në pompën e derivateve .... në Gjakovë ka qenë me një shok dhe më një shoqe të shokut, aty kanë ndejt së bashku, i kanë shkruar prej telefonit të shokut me njëfarë M..., e kam pasur ditëlindjen unë, dhe i kemi shkruar dhe na ka ardh të pompa, na ka sjellë sende me një kese, dhe ka qenë bashkë me A..., kurse ma ka jap pasagjeri, kurse ky shoferi më ka thënë se çka je ka bon se na merr në qafë, se kam grua e fëmijë, dhe pse nuk më ke treguar me herët se je ka vjen për këtë punë, dhe jam ndarë unë. Më tej ka deklaruar se natën kritike, shoku që është shoqëruar me të ka qenë Ernesti, shkurt e thirrin K..., me duket se K. e ka mbiemrin. Me tej ka shtuar se sendi që e ka marrë prej atij personi ka qenë pak lëndë narkotike, me sa e dinë ka qenë marihuanë, por nuk e përdor. Ndërsa kur është pyetur se këtij personi a i ka dhënë diçka i njëjti ka deklaruar se po ja ka lënë në tavolinë, një kese, nuk e ka këqyr se çka ka pasur në të dhe ka vazhduar. Po ashtu këtij personit që ka qenë në automjet ia ka dhënë parat e ai personi ka qenë pasagjeri. Nuk i kujtohet sa para saktë ja ka dhënë a kanë qenë 25 apo 40 €, por nuk i ka këqyr sa kanë qenë, të njëjtat kanë qenë të paluara sepse E... i ka thënë kështu jepja. E pyetur nga prokurorja se në prokurori ke deklaruar se “ndër të tjera shoku im E.. i ka shkruar në mesengjer në adresën Miri 22 me telefonin tim dhe menjëherë pas pak E.. me ka thënë: .... , ndërsa, sot në pyetjen time deklarove: “se i ka shkruar nga telefoni i vet”, cila është e vërteta, është shkruajtur mesazhi nga telefoni i yt apo nga telefoni i shokut tënd E..., i njëjti ka sqaruar se i ka shkruar prej telefonit të E...ose i ka shkruar edhe prej telefonit të tij sepse ka pasur shumë stresë gjatë parashtrimit të pyetjeve dhe nuk i kujtohet saktë. Me tutje është ballafaquar me deklaratën e dhënë në prokurori, lidhur me pranimin e substancës narkotike dhe dhënien e parave, ke deklaruar se :”unë A.. ia ka dhënë parat i cili po voziste pra, shumë prej 40.€-ve, e pastaj A.... ia dha pasagjerit, pra, kështu ka qenë”, ndërsa, sot deklarove që parat ia ke dhënë pasagjerit, cila është e vërtetë, i njëjti ka sqaruar se e vërteta është ajo të cilën e ka thënë në prokurori, pra, unë ia kam dhënë parat A... e pastaj A.. ia ka dhënë pasagjerit. Duke u pyetur nga Prokurorja se në polici ke deklaruar lidhur me faktin se si ke kontaktuar me personin apo personat që ishin me automjet . . . në këtë mënyrë: ”unë kam kontaktuar me ata persona, unë nuk kam kontaktuar me ata persona. E... dhe femra e tij kanë biseduar se nga kush do të marrin. Kështu, që, ata vendosen që kur porositen narkotikun, i thanë kinse e kishin për mua, pasi që me herët ata kishin mbetur borxh shitësit të narkotikut, a është e vërtetë kjo? I njëjti e ka pohuar një fakt të tillë. E.. e njeh qysh moti sepse ka luajtur futboll me të, dhe babai i vet shet orë të dorës. A.. e njeh pasi që njëherë moti ka blerë radiatora të ujit dhe qysh atëherë nuk ka pasur më kontakt me të. Duke u ballafaquar me përgjigjet e dhëna në polici i njëjti ka deklaruar lidhur me faktin se nga cili person që ka qenë brenda në automjet se keni kontaktuar, ju jeni përgjigjur se keni kontaktuar me vozitësin i cili nga pasagjeri ka marr narkotikun dhe më ka dhënë mua, e ka pohuar këtë deklaram, po ashtu e ka pohuar edhe faktin se A...i ka thënë pasagjerit, a mund më shpejt se po më merr në qafë, por këtë fakt deklarom se e ka përmend edhe në polici, por nuk e dinë se përse nuk e kanë shkruar ata. Duke u pyetur se në deklaratat e mëhershme ke deklaruar se sendi që ke marr nga personat në automjetin “. . .” ka qenë kokainë, ndërsa, sot e përmende që mund të ketë qenë marihuanë, cila është e vërteta, a ka qenë kokainë apo ka qenë marihuanë, i njëjti ka

sqaruar se të dyjave iu ka thënë njëjtë, sepse, nuk e ka qelë kesen me e kqyr, por policia i kanë thënë se është kokainë, dhe ka deklaruar ashtu sikurse ka thënë policia. Duke e ballafaquar me pyetjen e bërë nga ana e zyrtarit policor, çka mendoni me këtë fjalë e rëndë, çfarë kuptimi ka, ju keni deklaruar “mendoj që ka qenë substancë narkotike e llojit kokainë, pasi që, E... ka marr telefonin tim në banjo dhe aty nga telefoni im kishte konsumuar substancë narkotike. Këtë gjë e ka vërejtur kur e ka marr telefonin dhe ka shkuar në banjo ta pastrojë dhe aty ka vërejtur mbetje të kokainës, a është e vërtetë kjo, i njëjti ka sqaruar se për këtë arsye ka menduar se është kokainë, se kur e ka marr telefonin për këtë ka menduar. Telefoni nuk ka pasur shumë pluhur, por ka shkuar me e pastruar pasi që ka menduar se ka pasur kokainë.

*Duke u përgjigjur në pyetjet e parashtruara nga mbrojtësi i të akuzuarit A.SH., av. Meshari Selimaj, ku dëshmitari është pyetur se më herët deklarove se i ka shkruar adresës M.. 22” me telefonin e tij, ndërsa, në deklarinimin e tij të bërë në prokurori i njëjti deklaroi se: ”shoku im E... i ka shkruar në mesengjer, në adresë “...”, me telefon timin, pra, kemi të bëjmë me deklaratën në fq.2 të dëshmisë së tij në prokurori tek rreshti 7 dhe 8, e ndërkaq lidhur me këtë çështje në pyetjen e parashtruar nga zyrtari policor në deklarinimin e tij të dhënë në polici, se “si keni kontaktuar ju me personin apo personat që ishin në automjetin “. . .”, dëshmitari përgjigjet se: “nuk ka kontaktuar me ata persona, E.. dhe femra e tij kanë biseduar se nga kush do të marrin, e bazuar në këto tri deklarime të këtij dëshmitari pyetja ime është se: ”a qëndron pranë deklaratës së dhënë në polici ky dëshmitar, se ka kontaktuar me ata persona, a qëndron pranë deklaratës së dhënë në prokurori, se E..i ka shkruar “...” në mesengjer, apo mbetet pranë deklarinimit të sotëm se vetë dëshmitari Demokriti i ka shkruar me telefonin e tij adresës “..”, i njëjti është sqaruar se e vërteta është se E... i ka shkruar prej telefonit tim, e po ashtu shton se nuk dua që me pas probleme me familjen time, sepse të njëjtit më thojnë se unë kam qenë duke përdorë narkotik. I njëjti me tutje ka deklaruar se E... e njeh që dy vite përpara këtij rasti, me të njëjtin ka ndejtur kohë pas kohe, ka ndejtur në lagjen Koloni, kur ka qëndruar të axha. A...nuk e ka takuar asnjëherë në restorant, përveç këtij rasti që e ka takuar në “...”, saktë nuk e din orën por mendon se ka qenë 18,30/h. I akuzuari A.SH., , nuk ka parashtruar pyetje për dëshmitarin.*

Mbrojtësi i të akuzuarit M.XH., av. Korab Bokshi, dhe i akuzuari nuk kanë parashtruar pyetje për dëshmitarin.

## *2.d. Provat materiale*

*2.d.1. Nga Raporti i Oficerit H.S. i dt.03.03.2022, vërtetohet se gjatë hetimit të rastit 2022-DHTN-3, me masa të fshehta dhe teknike të hetimit dhe vëzhgimit, përkatësisht monitorimit të fshehtë të bisedave dhe shfrytëzimit të mjeteve për përcjelljen e vendndodhjes, është kuptuar se i dyshuari A.SH., shfrytëzon lokacione të ndryshme në qytetin e Gjakovës, për të fshehur doza të gatshme me substancë narkotike të llojit kokainë, e më pas varësisht prej kërkesave, i njëjti i shpërndan tek blerësit. I dyshuari A.H., fsheh dozat e kokainës nëpër vende të ndryshme, sepse nëse i mban me veti në veturë paraqet rrezik në rast se ndalohet nga policia për kontroll. Me datën 02.03.2022, kanë qenë në detyrë zyrtare nga ora 16:00 dhe këtë ditë kanë monitoruar lëvizjet e të dyshuarit A.SH., . Sipas pajisjes për lokalizim të vendndodhjes (GPS), një ndër vendet që i dyshuari më së shpeshti ka përdorur këtë ditë, për fshehjen e substancave narkotike, është rruga "...” përkatësisht tek "...". Këtë ditë, A.. ka shkuar në këtë lokacion dy herë. Në ora*



23:37 datës 02.03.2022, zyrtari H.S. dhe rreshter U.H., ID#1052, gjatë këqyrjes së lokacionit ku ka ndaluar A.SH., , tek një trafo e rrymës, kanë vërejtur një paketim të plastikës me mbishkrimin "Magnesium", të cilën e kanë hapur me kujdes dhe kanë vërejtur se aty ndodheshin rreth 8 deri 10 qese najloni të mbushura me substancë narkotike të llojit kokainë, të gatshme për shitje. Për arsye të mos prishjes së provave dhe gjurmëve të gishtave, njësia e tyre e përbërë nga rreshter U.H., ID#1052, A.B., ID#4748, SH.S. ID#6004 dhe H.S. ID#9101, kanë vendosur që mos ti tërheqin dhe të presin deri sa i dyshuari A.SH., , të vij ti marr dhe ta arrestojnë në flagrancë. Rreth orës 01:00 të datës 03.03.2022, i dyshuari A... ka shkuar tek lokacioni ku i kishte fshehur substancat narkotike, kurse zyrtaret policor ishin duke pritur të fshehur në një distancë të caktuar dhe posa A.i është ulur për ta marrë paketimin e magnesiumit me doza të kokainës, janë nisur në drejtim të tij, mirëpo A.i me të vërejtur prezencën e policisë, me shpejtësi ka marrë dozat me kokainë dhe ka filluar të ikë me vrap. Gjatë ndjekjes e sipër, kur janë afruar tek ura e lumit K...A.. ka hapur kutinë e magnesiumit dhe së bashku me dozat e kokainës e ka gjuajtur në lumin "Krena", duke asgjësuar kështu edhe provat materiale. Disa metra pasi ka gjuajtur provat, kanë arritur ta ndalojnë dhe ta arrestojnë. I njëjti gjatë arrestimit ka rezistuar, mirëpo duke përdorur forcën e butë, duarthatë, kanë arritur që ta arrestojnë. Po ashtu gjatë ikjes i njëjti nuk i ka zbatuar urdhrat ligjor për t'u ndalur dhe qëllimi i vetëm i tij ka qenë që ti asgjësoj provat materiale përkatësisht, dozat me kokainë. Pas arrestimit janë kthyer tek vetura e tij, e markës . . . , ngjyrë e zezë, me targa . . . , ku brenda në veturë ishin edhe pasagjerët M.XH., dhe M.G., , për të cilët gjatë hetimit me masa të fshehta kanë vërtetuar se të njëjti i kanë ndihmuar të dyshuarit A.... në veprimtarinë e shitjes së kokainës. Gjatë kontrollit të veturës . . . , nuk kanë gjetur diçka të dyshuar, mirëpo në veturë janë gjetur dhjetëra paketime të magnesiumit, të cilat i dyshuari A. i ka përdorur për të fshehur doza me kokainë dhe më pas i ka fshehur në pjesë të ndryshme të qytetit. Po ashtu kanë kontrolluar edhe veturën . . . , ngjyrë e gjelbër me targa ..., të cilën e kishte në shfrytëzim, i dyshuari M.XH., , mirëpo nuk është gjetur asgjë e dyshuar. Rreth orës 06:10, në mëngjes, me urdhër të prokurorit kanë kontrolluar shtëpinë e të dyshuarit A.SH., dhe kanë gjetur 4200 € dhe të njëjtat janë konfiskuar.

2.d.2. Nga Raporti i Oficerit SH.S., i dt.03.03.2022, vërtetohet se pas marrjes së informatave nga njësitë brenda Policisë dhe informatave të zyrtareve në teren se personi A.SH., është duke kryer veprën e shitblerjes së narkotikëve në qytetin e Gjakovës me datën 29.12.2021 dhe ju janë drejtuar me shkresë zyrtare Operatorëve Telefonik Vala me nr. Referencës 06/2-02/2600/2021 dhe Ipko me nr. Referencës 06/2-02/2601/202, se personi në fjalë a posedon ndonjë numër nga kompanitë lartcekura dhe se a është ndonjëri nga këta numra aktiv pasi kishin informata se janë në përdorim nga A.i: . . . , . . . dhe . . . . Me datën 29.12.2021 kanë pranuar e-mailin se i njëjti person ka në përdorim nga operatori vala nr. 044/763090 në emër të tij, që nga data 29.12.2014, kurse nr. . . . është në emër të R. M., dhe nr. . . . është në emër të B.A., , kurse tek operatori Ipko nuk ka asnjë nr. në përdorim. Me dt. 10.01.2022 DHTN-Gjakovë me shkresë zyrtare nr. 06/2-02/20/20120 i janë drejtuar DKR në Prokurorinë Themelore Gjakovë për fillimin e hetimeve me masë të fshehtë të hetimit ndaj personit të dyshuar: A.SH., , me numra telefoni në shfrytëzim . . . dhe . . . . Me datë 13.01.2022 kemi dorëzuar në zyrën e përgjimit ligjor urdhëresën mbi fillimin e masës se fshehtë të lëshuar nga Gj. Th. Gjakovë me nr. PPR.KR.nr.3/2022 dhe kanë filluar masën e fshehtë të përgjimit të thirrjeve telefonike dhe mesazheve të kërkuar nga ana e njësisë DHTN-Gjakovë, në lidhje me personin e dyshuar A. Sh.. Me dt. 17.01.2022 DHTN-

Gjakovë me shkresë zyrtare nr. 06/2-02/95/2022 i janë drejtuar DKR në Prokurorinë Themelore Gjakovë për vazhdimin me masë të fshehtë të hetimit dhe të një numri telefonik të dyshuarit: A... dhe atë numrin e telefonit në shfrytëzim .... Me datë 20.01.2022 kanë dorëzuar në zyrën e përgjimit ligjor urdhëresën e dytë mbi fillimin e masës së fshehtë të lëshuar nga Gj. Th. Gjakovë dhe kanë filluar masën e fshehtë të përgjimit të thirrjeve telefonike dhe mesazheve të kërkuara nga ana e njësisë DHTN-Gjakovë dhe kanë ndërmarr veprime hetimore në lidhje me personin e dyshuar A... Sh.. Me datë 21.01.2022 pasi që kërkesa e parë për përgjim të numrit të telefonit ..., ka qenë i shkruar gabim pasi numri ka qenë .. e kanë tërhequr urdhëresën e parë të datës 13.01.2020 dhe kanë dorëzuar në zyrën e përgjimit ligjor urdhëresën e dytë mbi fillimin e masës së fshehtë të lëshuar nga Gj. Th. Gjakovë dhe kanë filluar masën e fshehtë të përgjimit të thirrjeve telefonike dhe mesazheve të numrave .. dhe .. të kërkuar nga ana e njësisë DHTN Gjakovë dhe kanë ndërmarr veprime hetimore në lidhje me personin e dyshuar A.SH., Me dt. 25.01.2022, DHTN-Gjakovë, me shkresë zyrtare nr. 06/2-02/154/2022, i janë drejtuar DKR në Prokurorinë Themelore Gjakovë për vazhdimin me masë të fshehtë të hetimit për vendosjen e pajisjes GPS me zë në veturën . . ., ngjyrë jeshile, me targa . . , të cilën e përdor i dyshuari A..Sh.. Me datë 26.01.2022 kanë pranuar urdhëresën për vendosjen e pajisjes se monitorimit të fshehtë të bisedave në veturë dhe vendndodhjes të lëshuar nga Gj. Th. Gjakovë, në veturën ... Me datën 29.01.2022, rreth orës 23:00, kanë vendosur pajisjen GPS me zë në veturën e të dyshuarit. Gjatë monitorimit të bisedave të dyshuarit brenda automjetit . . ., dëgjohej biseda që implikojnë të dyshuarin A.SH., , në shitje të substancave narkotike të llojit si më poshtë: Datë 30/1/2022, ora 00:26, bisedë ndërmjet të dyshuarit A.SH., (dhe personit M.XH., , i njohur me nofkën ". . . "). Gjatë bisedës të lartcekurit flasin për njerëz tjerë që i ekzagjerojnë gjërat në lidhje me shitje të narkotikëve. I dyshuari A.... thotë se mund të ndodh edhe bastisja në shtëpi, në këtë aspekt i thotë duhet të jesh i qetë, thatë e la shtëpinë (pa mall), thatë, thatë. Biseda më pastaj vazhdon, i dyshuari i thotë se dy copa (qese narkotike), secila në vlerë nga 50 € dhe qeto dyja ja japa H.M i njohur si H.A., dhe tash shtëpinë e ka xhenet, që do të thotë se nuk ka asgjë aty. I dyshuari e sugjeron M...që nëse ndonjëherë ndalesh nga policia, narkotikun që ka në posedim ta gjuaj, duke mos u brengosur se ato mund të humbin apo të merren nga dikush tjetër. Kryesorja është që ato gjëra të mos merren nga policia. Me datë 31/1/2022, ora 20:12, i dyshuari në automjet është me personin SH.B..., , të cilët shkojnë në ... dhe ndalen tek fusha e futbollit. Aty takojnë një person me emrin V..., të cilit i jep 7 copa dhe si pagesë merr 140 €. I dyshuari pa dal fare nga automjeti, i thotë personit të quajtur V... merri se ke në bagazh. Ndërkohë dëgjohej SH.B., , se përse këtu, ka gjithkrah kamera. Me datë 31/1/2022, ora 21:24, bisedë ndërmjet të dyshuarit A... dhe personit M.XH., , i njohur me nofkën "Cakani". Gjatë bisedës flasin për një sasi narkotiku që i dyshuari A. kishte dhënë për shitje. I dyshuari pyet M... se kishte diçka, kurse M.. përgjigjet se jo, po ti. I dyshuari A. përgjigjet se deri tani kishtë shitur 600 €. Biseda më pastaj vazhdon se në lokalit ku punonte M... kishtë shkuar një person të cilin e përmend si B.H., , i cili fillimisht kishtë kërkuar nga ai që ta thërras të dyshuarin A..në telefon për të blerë kokainë. Pasi që M...kishtë pohuar se nuk po mundet të lidhet me të në telefon, B.H., kishtë thënë po të jap paratë ty dhe blej ti në vend timin, mirëpo M...kinse nuk kishtë të bëj me asi gjëra ka refuzuar një gjë të tillë edhe përkundër faktit se ai kishtë në posedim vetë narkotik të llojit Kokainë për shitje, që kishtë pranuar më herët nga i dyshuari A.. Aty në bisedë dëgjohej kur M...i thotë të dyshuarit A... se edhe Rr.H., nga Gjakova, i cili njihet edhe si B.H., , një përdorues i madh i substancave narkotike, kryesisht i Kokainës, një person problematik dhe një borxhli i madh. Besojmë që kjo ka qenë edhe arsyeja

se personi M.Xh., nuk kishte shitur narkotik. Me datë 31/1/2022, ora 22:12-22:26, i dyshuari është vetë i dyti në automjet dhe dëgjohej duke biseduar me personin M.G., , i njohur me nofkën ". . .", i cili është brenda automjetit. Fillimisht bisedojnë për shitjen e narkotikëve gjatë orëve të vona të natës. I dyshuari gjatë bisedës thotë se kur të bëhet ora 03:00 i natës është i pa konkurrencë. Nga ora 00:00-06:00 ti i ki nëse i shet 300 € ditë që i thojnë 100 € fitim, duke joshur personin që edhe ai të merret me shitje të narkotikëve. Me datën 31.01.2022, rreth orës 01:40, File 121, A... gjatë bisedës me A.B., , tek shtëpia e tij, i tregon se ka një kg Kokainë të egër me mbishkrimin Dolce Gabana, të cilën e ka të futur në oriz dhe e ka të fshehur një gjysmë metër nën tokë dhe se e ka të hapur një kg tjetër me të butë të cilën e ka shitur 500 gram. Sipas A., ... kokaina e egër nuk shitet në dimër por vetëm kjo e buta. I dyshuari vazhdon bisedën duke treguar se kur ka qenë në arrest shtëpiak në orët vona të natës edhe pse ishte në arrest shtëpiak, dilte deri në ora 07:00 në mëngjes duke shitur narkotik. Gjatë kësaj bisede, i dyshuari ka thënë se pas orës 03:00, kishte fituar 300 €, pasi që në këtë kohë është i pa konkurrencë dhe se nata më e dobëta është 120 €. Me dt. 01.02.2022, ora 21:15, personi L.D., a, i kërkon 3 qese narkotik A..., ndërsa A..i i thotë se i ka të fshehura tek .. dhe së bashku me veturë nisen që ta marrin narkotikun, mirëpo rrugës e vërejnë policinë afër ...dhe nisen në lokacion ku A...i fsheh narkotikun tek T..., i jep narkotikun L.. (këtë bisedë dhe vendi ku është ndalur për të marrë narkotikun e kanë të vërtetuar përmes GPS-sit me zë) dhe i tregon se ka hapur një Kompani të Bastores, ku klientëve ju ka thënë që kur i telefonojnë t'i thojnë qitmi 120 € (që don të thotë 3 qese kokainë nga 40 €) (dhe në rast se ju zejn najherë të thoni që kam luajtur bastore edhe nuk koritën edhe unë pshtoj ma kallaj. Datë 02.02.2022, ora 00:18, A.. shkon e merr tek shtëpia e tij M... dhe në momentin që hyp në veturë M.. i thotë A.. se s' di sa telefonata i pata nga një person që nuk përmendet emri i cili sipas M..i ka thënë t'ja lejë 40 € jo 50 dhe se sjom ka ta lypi pa pare (fjala për kokainë), ndërsa A... i thotë se pi njihka mallin ky dhe se duhet me shku te A,,, (Buza për ti dërguar kokainë pasi është blerës) pastaj te dugoja (fjala për të marre kokainën në vendin ku e fsheh në çarshinë e Vjetër tek dugoja e babës se tij punëtori i ujës-jellësit) mirëpo në momentin që shkon tek ai lokacion nuk e gjenë narkotikun të cilin e ka fshehur, sipas tij kanë qenë 6 doza kokainë dhe dyshon tek një person me emrin D,,, që sipas tyre mund të jetë D.R., po ashtu ti dërgoj dhe narkotik personit D.M tek lokali bilardo i Milles dhe sipas M.XH., këtij personi i kanë dërguar dhe dy herë tjera. Me datë 02.02.2022, ora 01:18, A.i e dërgon M...afër .... dhe M.. ngjitet në banesë, aty, atëherë dhe dërgon narkotik ku sipas tij atë narkotik ja merr një femër, po ashtu dhe me: datë 1.02.2022, ora 22:29, së bashku janë në veturë A., M.. dhe M.G., dhe ndalen tek ..., ku M.. zbret nga vetura dhe i dërgon në banesë narkotik ku sipas tij del një femër (e cila sipas tij shitet me pare) dhe të cilën e ka pyetur se a donë të 40 apo 50 € kokainën, personin i cili është me këto femra që porosit narkotikun e njihet nga i paraqituri M.G., . Me datë 2.02.2022, ora 01:24, A... i thotë M..., se u "djeg" vendi tek ...dhe se vendi tek Taphonët, ku i fsheh dozat me kokainë është vend i sigurt, pasi është errësirë dhe ka pak lëvizje të personave dhe nuk mund ta kapin kamerat e shkollës "... dhe të vetmet kamera që mund ta kapin janë ato tek "..., por të cilat sipas tij nuk mund të jenë fakt në polici. Më pas gjatë bisedës M..e këshillon që kur të del tek Taphonët për ta fshehur mallin, ta heq rrypin e pantallonave që nëse e sheh dikush mendon se është duke urinuar, më pas A.i i thotë se kur parkohet të .. së pari pret disa minuta për tu siguruar që nuk ka lëvizje të personave e pastaj shkon dhe i fsheh dozat me kokainë. Me datë 3/2/2022, ora 01:40, i dyshuari është vetëm në automjet, shkon në Rr. ...-së për të shitur narkotik, ndalet para ndërtesave të KRU ". dhe Ba..për B.. Aty takon një person të panjohur të cilit i shet

narkotik. Pa ashtu dëgjohet kur i dyshuari i thotë personit se tek rrethi kishte parë një patrullë policie dhe se është dashur që të fsheh brenda gojës. Me datë 3/2/2022, ora 03:22, i dyshuari është vetë i treti në automjet dhe dëgjohet duke thënë personave që ka brenda automjetit, se si i kishte shitur një personi Kokainë në ora 04:00, në 09:00, sabah ka shkuar dhe vra njërin dhe më ka thirr në telefon më ka thonë baba sheh mos të ha k... në rregull je me mu, që kuptohet se me këto fjalë se ai nuk do të tregonte se kishtë marrë kokainë nga i dyshuari A.SH.,. Personin që përmend i dyshuari thotë se është nipi i . . . që kishtë vrarë një person me mbiemrin Hana në një lokal Hamburgeri. Personat që kanë qenë brenda automjetit dyshohet se janë D.S., , i njohur me nofkën ... dhe V.D.nga Gjakova. Me datë 3/2/2022, ora 03:47-03:53, i dyshuari është vetë i treti në automjet dhe dëgjohet duke i thënë personave që ka brenda automjetit se ai furnizon shumë persona kah fshatrat e ..., përmend ., .. që i furnizon me narkotik të llojit Kokainë, duke thënë se nuk ka lënë vend pa dërguar mall, përmend personin L.K., kamarier. Personat që kishin kryer një grabitje i kishte pasur myshteri, pasi tek ai kishin marrë kokainë në vlerë prej 800 €. I dyshuari ka përmendur një bisedë që ka pasur me D.H.,, i cili kishte informuar se personat që kishin kryer grabitjet ishin në burg me ta dhe se ata nuk do të tregonin se me paratë që kishin grabitur kishin blerë kokainë nga ....A.SH., Me datë 3/2/2022, ora 04:56, i dyshuari është vetë i treti në automjet (dhe dëgjohet duke thënë personave që ka brenda automjetit, se si fiton ka 25 € për një gram. Me datë 3/2/2022, ora 05:00, i dyshuari kryen një shitje në Rr. ,, afër semaforëve, përball ,,,". Me datë 3/2/2022, ora 05:02, i dyshuari është vetë i dyti brenda në automjet së bashku me personin D.S.,, i njohur me nofkën ..... Fillimisht bisedojnë rreth shitjes dhe përfitimit që i dyshuari ka nga shitja e narkotikëve, i tregon se si nga shitja e narkotikëve për një muaj e njëzet ditë ka fituar 70000 €. Me datën 29.01.2022, rreth orës 23:00, kanë arritur ti vendosin pajisjen GPS me zë në veturën . . ., të cilën e përdor i dyshuari. Me datën 01.02.2022, rreth orës 01:49, M.XH., hyp në veturë te A... dhe i tregon se një person i ka lyp njëherë ti dërgoj 2 gram, pastaj i ka thënë një gjysmë grami. Gjatë monitorimit të bisedave arrihet të kuptohet se i dyshuari është duke konsumuar veprën e shitblerjes se narkotikëve, mirëpo me datën 03.02.2022, rreth orës 05:30, në mëngjes i dyshuari ka ndaluar veturën dhe këtë veturë nuk e ka përdorur më, pasi sipas vëzhgimeve tona dhe përgjimit i dyshuari ka blerë veturë të re. Gjatë vëzhgimit në teren kanë vërejtur se nga data 03.02.2022, A.SH.,, është duke shfrytëzuar automjetin . . . B, ngjyrë e zezë, me targa . . ., me nr. të shasisë V SX000073P6018188, me pronar D. M. nga Gjakova. Andaj me datën 07.02.2022 kanë bërë kërkesë pranë P.TH-Gjakovë që të lëshohet urdhëresa për vendosjen e pajisjes GPS me zë në veturën . . . B. Me datën 07.02.2022 është pranuar urdhëresa nga P.TH-Gjakovë për sigurimin e video incizimeve nga .... filiala në Gjakovë, të cilën e kanë dorëzuar po këtë ditë në Bankë. Me datën 7.07.2022, kanë pranuar urdhëresën me nr. PPr.KR.nr.3/2022 që ka të bëjë me Urdhëresë për ndërprerje të Masave të Fshehta, sa i përket numrit të telefonit ... nr. i cili në bazë të përgjimeve del të jetë numri i R.M.,, bashkëshortja e A... por që dyshimet kanë qenë se përdoret nga A... Me datë 08.02.2022, kanë pranuar urdhëresën për vendosjen e pajisjes së monitorimit të fshehtë të bisedave dhe vendndodhjes në veturën . . . B, me pronar D.M., nga Gjakova. Me datën 10.02.2022 kanë pranuar një CD me incizim nga BPB-Banka të datës 03.02.2022, rreth orës 01:40 ku tek KRU-., .A.,i dërgon narkotik një personi për momentin të panjohur mirëpo në momentin e dërgimit të narkotikut A.i i thotë këtij personi se i pash policinë të rrethi, andaj e mshefa në gojë (fjala për narkotik). Me datën 12.02.2022, rreth orës 04:50, janë mundur që ti vendosin pajisjen GPS për vendndodhjen e veturës. Me dt. 25.01.2022 DHTN-Gjakovë me shkresë zyrtare nr. 06/2-02/339/2022 i janë drejtuar DKR në Prokurorinë Themelore

Gjakovë, për vazhdimin me masë të fshehtë të hetimit për vendosjen e pajisjes GPS me zë në veturën . . . , të cilën e përdor i dyshuari M.... Duhet theksuar se këtë veturë e ka përdorur me herët i dyshuari A. Sh. dhe pajisja GPS me zë në këtë veturë është e vendosur që nga data 29.01.2020, por nga data 03.02.2022, këtë veturë A... i'a ka shitur të dyshuarit M.XH., i cili po ashtu është duke konsumuar veprën e shitblerjes së narkotikut në bashkëpunim me A.... Me datën 18.02.2022, në bazë të pajisjes për lokalizim të vendndodhjes GPS, A..., rreth orës 18:30, ndalet tek pompa e derivateve "...Company", që ndodhet në fshatin G., Komuna Klinë. Në bazë të dyshimeve është duke bërë shitblerje të substancave narkotike pasi A.. ka shkuar (disa herë të tjera në atë lokacion dhe përafërsisht në të njëjtën kohë, andaj kanë shkuar në pompën e derivateve "... ku kanë shikuar dhe analizuar kamerat e sigurisë, ku në ora 18:37, të datës 18.02.2022, është vërejtur një veturë e markës BMW X3, ngjyrë e hirit, me targa ..., e cila hyn në hapësirat e pompës për t'u furnizuar me derivate. Nga vetura BMW, X3, del personi tashmë i identifikuar si B.L., i cili hyn në marketin e pompës. Po ashtu në veturën BMW X3, në ulësen e parë të pasagjerit është e ulur një person i gjinisë femërore. Në ora 18:38, me veturën . . . , vjen i dyshuari A... Sh. i cili po ashtu parkohet në hapësirën e pompës "...". Pasi parkon veturën, A.. del nga vetura . . dhe vjen në drejtim të veturës . . , ku së pari përshëndetet me pasagjerin, e më pas B.del nga marketi dhe takohet me A.Pasi përshëndeten, A... hyn në veturën . . . , në anën e pasme mbrapa shoferit, e më pas hyn edhe B.. Pasi që të dy hyjnë në veturë, në momentin kur vetura fillon të lëvizë, i dyshuari A.me dorën e majtë, nga xhepi i majtë nxjerrë diçka që dyshohet të jetë substancë narkotike e llojit kokainë dhe sipas dyshimeve tona të njëjtën ia jep B. Më pas vetura vazhdon në një pjesë ku nuk është e mbuluar me kamera. Në ora 18:40, vetura . . . vazhdon rrugës për Prishtinë. Po ashtu me datën 17.02.2022, rreth orës 18:38, shihet një veturë e markës BMW 320, ngjyrë e hirit, e cila kalon përmes hapësirave të pompës ",," dhe shkon e ndalet tek vendi ku GPS e ka dhënë lokacionin e veturës . . . , të cilën e vozit A..e cila dyshohet të jetë vetura e shtetasit b.L., BMW, por të cilës nuk mund ti shihen targat qartë në kamera. Po ashtu me datën 31.01.2022, rreth orës 18:42, pajisja GPS e lokalizon veturën . . . me targa ..-MR, të cilën këtë ditë ishte duke e vozitur A., dhe së bashku me të në veturë ishte edhe SH.B., ku në bazë të bisedës së tyre A., ka shitur kokainë në vlerë prej 700 € në atë lokacion. Me datën 21.02.2022, kemi bërë kërkesë pranë P.TH-Gjakovë për nxjerrjen e Video incizimeve të datës 18.02.2022, nga ora 18:30 deri 18:45, nga Pompa e Benzinës „,...“ që ndodhet në fshatin ..-Klinë, pasi që i dyshuari bën takim me një person të panjohur për shitblerje narkotiku. Me datën 23.02.2022, kanë pranuar USB nga pompa e derivateve .. nga fshati ..-Klinë, ku shihet A.. duke u takuar në atë vend me personin B.S.,. Me datën 01.03.2022, kanë bërë kërkesë pranë P.TH-Gjakovë për nxjerrjen e Video incizimeve, të datës 28.02.2022 nga ora 18:00 deri 19:00, nga Pompa e Benzinës „,...“ që ndodhet në Rr. . . . , në Gjakovë, pasi që i dyshuari bën takim me një person të panjohur për shitblerje narkotiku.

*2.d.3. Nga Raporti plotësues i dt.23.03.2022, vërtetohet se gjatë materialit të përgjimit, konkretisht dosja 179 dt.01.02.2022, dëgjohen të pandehurit A..dhe M., të cilët shkojnë në afërsi të shtëpisë së dëshmitarit A.B. dhe i shesin narkotikë duke i thënë ”a tu dok se është mall ma light (ma e butë), po ashtu nga dosja 182 dt.01.02.2022, dëgjohen të pandehurit A. dhe M...r, të cilët shkojnë afër një banese për të dërguar kokainë tek një femër, ku i pandehuri M. zbrit nga automjeti dhe ngjitet lartë, ku dëgjohet A..duke i thënë dikujt se e dërgova M. lartë, e pasi që kthehet i pandehuri M...thotë “ku far femre ishte” dhe aty përmendet kokainë 40 €, dhe lokacioni*

ku ata janë ndalur ka qenë rr. . . .”, ku narkotiku i është dërguar dëshmitares E.S.T., , të cilën e ka konfirmuar edhe e njëjta në deklaratën e saj. Po ashtu nga dosja 486 dt.18.02.2022, gjatë dëgjimit të materialit të përgjimit kuptohet se brenda në automjet është i pandehuri M..., i cili thirret në telefon nga dëshmitarja E.S-T., ku M...i i thotë të zbres poshtë banesës tek vendi ku lija Pick up përpara, ku e njëjta zbret poshtë takon të pandehurin M... dhe i merr një dozë kokainë 50-she (fjala është për 0.50 gram), ku dëgjohet i pandehuri M..duke i thënë se paskan vendosur edhe kamerat.

2.d.4. Nga vërtetimet mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i dt.03.03.2022, vërtetohet se nga i akuzuari A.SH., , janë sekuestruar para të gatshme 8x200 €, 11x100 €, 30x50 €, total 4200 €. Po ashtu nga vërtetimi tjetër i të njëjtës datë vërtetohet se të akuzuarit A.SH., , i janë sekuestruar para të gatshme 3x100 €, 6x50 €, 1x10 €, 1x5 €, 3x2 €, 4x1 €, 4x0.50 €, 5x0.20 € dhe 2x0.10 € total 628.20 €. Po ashtu 1x500 lekë, si dhe një telefon i markës Iphone, ngjyrë e zezë, së bashku me sim kartelë, nr. i panjohur. Po ashtu nga vërtetimi i të njëjtës datë të akuzuarit A.SH., i është sekuestruar automjeti . . . , ngjyrë e zezë, me targa .... Ndërsa të akuzuarit M.XH., i është sekuestruar një veturë e tipit . . . , ngjyre e gjelbër, me targa . . . , si dhe të holla dhe atë: 2x100 €, 8x50 €, 2x20 €, 1x10 €, 1x5 € dhe 1x2 € në total 657 €, 17x1 dollar amerikan, 3x20 funta, 1x10 franga zvicerane, 1x2000 lekë, 1x1000 lekë, një telefon mobil Iphone 7 plus së bashku me sim kartel . . . .

2.d.5. Nga Procesverbali për kontroll dhe sekuestrim të përkohshëm i dt.03.03.2022, vërtetohet se nga zyrtarët policor është kryer kontrolli i shtëpisë së personit H.SH., , në rrugën SH.G., , nr. 115 dhe nuk është gjetur asgjë e dyshimtë si dhe është kryer bastisja e shtëpisë së të akuzuarit A.SH., në rrugën Sh.G., , nr. 15 dhe të njëjtit i janë konfiskuar 4200 €.

2.d.6. Nga ekspertiza për ekzaminimin e telefonave e datës 26.06.2022, vërtetohet se telefoni Iphone X, me Imei 353054094307469, nuk është ekzaminuar për arsye se ka pasur kod të sigurisë të panjohur dhe nuk është arritur tejkalimi i kësaj sigurie.

2.d.7. Nga Raporti i ekspertimit për ekzaminimin e narkotikut AKF/2022-1580/2022-1528 dt.30.05.2022, rezulton se sipas përbërjes kimike Dëshmitë #1.1, #1.2, #1.3, #1.4, #2.1, #2.2, #2.3, #2.4, #3.1, #3.2, #3.3, #3.4, #3.5, #3.6, #3.7, #4.1, #4.2, #4.3, #4.4, #4.5, #4.6, #4.7, #5.1, #5.2, #5.3, #5.4, #5.5, #5.6, #5.7, #6.1, #6.2, #6.3, #6.4, #6.5, #6.6, #7.1, #7.2, #7.3, #7.4, #7.5, #7.6 dhe #7.7, përmbajnë Kokainë, në peshë neto të përgjithshme prej 87.59 gram+0.0001gram.

2.d.8. Nga Informata lidhur me zbatimin e urdhërësës verbale për bastisje, e dt.01/03.05.2022, vërtetohet se me datë 30.04.2022, rreth orës 23:10, njësia e DHTN-së, kanë kontrolluar shtëpinë e të dyshuarit A.SH., dhe gjatë kontrollit është konfiskuar në cilësi të provës materiale dëshmia si në vijim: Dëshmia D#8, një paketim i plastikës që shërben për paketimin e vitaminave me mbishkrimin “Ca+vit C”, brenda të cilit kishte katër doza të mbushura me substancë në formë pluhuri, ngjyrë e bardhë që dyshohet të jetë narkotik i llojit kokainë, të gatshme për shitje me peshë rreth 1.69 gram. Ky paketim është gjetur me magnet në gilinderat e oborrit afër derës së hyrjes. Po ashtu brenda oborrit të shtëpisë, përkatësisht brenda ullukut që shërben për shkarkimin e ujërave atmosferik të shtëpisë, kanë gjetur 6 paketime të plastikës që shërbejnë për paketimin

e vitaminave (Magnesium) të markës “Heilusan”, brenda të cilave kishtë 225 doza të mbushura me substancë në formë pluhuri, ngjyrë e bardhë, që dyshohet të jetë narkotik i llojit kokainë, të gatshme për shitje me peshë rreth 107.66 gram. Të gjitha evidentohen veç e veç si Dëshmia D#9/1, 14 doza të mbushura me substancën formë pluhuri ngjyrë e bardhë që dyshohet të jetë narkotik i llojit kokainë, të gatshme për shitje me peshë rrejt 6.18 gram, Dëshmia D#9/2, 45 doza të mbushura me substancë në formë pluhuri, ngjyrë e bardhë, që dyshohet të jetë narkotik i llojit kokainë, të gatshme për shitje me peshë rrejt 21.27 gram, Dëshmia D#9/3, 46 doza të mbushura me substancë në formë pluhuri, ngjyrë e bardhë, që dyshohet të jetë narkotik i llojit kokainë, të gatshme për shitje me peshë rreth 21.27 gram, Dëshmia D#9/4, 45 doza të mbushura me substancë në formë pluhuri, ngjyrë e bardhë, që dyshohet të jetë narkotik i llojit kokainë, të gatshme për shitje me peshë rreth 20.87 gram, Dëshmia D#9/5, 35 doza të mbushura me substancë në formë pluhuri, ngjyrë e bardhë, që dyshohet të jetë narkotik i llojit kokainë, të gatshme për shitje me peshë rreth 18.86 gram, Dëshmia D#9/6, 40 doza të mbushura me substancë në formë pluhuri, ngjyrë e bardhë, që dyshohet të jetë narkotik i llojit kokainë, të gatshme për shitje me peshë rreth 18.71 gram. Në total janë konfiskuar 229 doza me kokainë me peshë të përgjithshme 109.35 gram.

2.d.9. Nga raporti informues 15 ditor mbi zbatimin e masave të fshehta, dt.02.02.2022 dhe 15.02.2022, vërtetohet se me datë 29.01.2022 në automjetin . . . me targa ... që është në posedim të dyshuarit A., njësia për mbështetje teknike e policisë në automjetin e lartcekur ka vendosur GPS dhe pajisjen për përgjim të bisedave brenda automjetit. Me datë 30.01.2022 është filluar të dëgjohet përgjimi i bisedave brenda automjetit dhe është kuptuar se i dyshuari A., është duke u marrë me shitje të substancës narkotike të llojit Kokainë.

2.d.10. Nga CD-të, tre copë, vërtetohen lëvizjet e të pandehurit dhe shitja e narkotikëve të përshkruar si në pikën 2.d.1. të këtij aktgjykimi.

## 2.e. Mbrojtja e të akuzuarve

2.e.1. I pandehuri A SH., gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohet, ndërsa është mbrojtur në heshtje.

2.e.2. I pandehuri M.XH., , gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohet, ndërsa është mbrojtur në heshtje.

## 2.f. Fjala përfundimtare<sup>1</sup>

2.f.1. Prokurorja e Shtetit Ervehe Gashi, në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, e cila është pjesë e shkresave të lëndës dhe të cilën e ka elaboruar në shqyrtim gjyqësor, ka theksuar se në këtë çështje penale gjatë shqyrtimeve kryesore të mbajtura pranë kësaj gjykate, e në bazë

---

<sup>1</sup> Prokurorja e shtetit, mbrojtësi i të akuzuarit A.Sh, av. Meshari Selimaj dhe mbrojtësi i të akuzuarit M.Xh., av. Korab Bokshi, fjalët e tyre përfundimtare i kanë parashtruar me shkrim dhe të njëjtat janë pjesë përbërëse e shkresave të lëndës.

të provave të administruara materiale dhe personale, është vërtetuar gjendja faktike se të akuzuarit kanë kryer veprat penale siç akuzohen në aktakuzë. Nga provat materiale të siguruara dhe të administruara në shqyrtimin gjyqësor, rezulton se të akuzuarit M.XH., dhe A.SH., u me veprimet e tyre kanë konsumuar veprat penale të përshkruara nën pikën 1 dhe nën pikën 2 të Aktakuzës, që prokurori i shtetit e përfaqëson, nga se nga këto prova rezulton se substancat narkotike të llojit kokainë në sasi të cekura nën pikën 1 dhe 2 të Aktakuzës, të njëjtit i kanë shitur dhe kjo është vërtetuar nga rezultati i aplikimit të masave të fshehta, e që e njëjta ka mbështetur në provat tjera materiale dhe personale.

2.f.2. Mbrojtësi i të akuzuarit A.SH., , av. Meshari Selimaj, në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, e cila është pjesë e shkresave të lëndës dhe të cilën e ka elaboruar në shqyrtimin gjyqësor, ka theksuar se gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor me administrimin e provave personale dhe materiale u vërtetua se i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale sipas kualifikimit juridik nga neni 267 parag.2 të KPRK-së, por veprën penale nga neni 267 paragrafi 1 i KPRK-së. Gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor nuk janë vërtetuar pretendimet si në dispozitiv të aktakuzës se kush janë "personat të ndryshëm", që i pandehuri iu ka shitur narkotikun për çka asnjë nga dëshmitarët e prokurorisë nuk ka deklaruar në shqyrtim gjyqësor se kanë blerë narkotik nga i pandehuri A..pastaj cilat janë ato fshatra të komunës së Gjakovës, ku i njëjti e ka shitur narkotikun, apo shprehja e përmendur „edhe më gjerë" çka është vërtetuar me shprehjen e dhënë "edhe më gjerë:" kinse për shitje të narkotikut. I ka kërkuar gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor për veprën penale nga neni 267 par.1 të KPRK-së, të merr parasysh faktin se i njëjti në çdo fazë të procedurës ka deklaruar se e ka kryer veprën penale nga ky paragraf, e që e nënkupton në parim pranimin e fajësisë ndonëse jo sipas kualifikimit juridik si në aktakuzë, pendimin për veprën e kryer dhe premtimin që nuk do ta përsërisë asnjëherë tjetër, rrethanat personale të kryesit dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale ku i njëjti nuk e ka përsëritur veprën në fjalë dhe asnjë vepër tjetër penale, dhe faktin se është martuar dhe tashmë ka një fëmijë të lindur në martesë dhe pret edhe një fëmijë tjetër që të lind së shpejti, sjellja e tij tregon që është orientuar në konsolidimin e familjes larg veprimeve të kundërligjshme, moshën e re të të pandehurit dhe keqardhjen e shfaqur gjatë kësaj kohe si dhe sjelljen korrekte gjatë gjykimit dhe sjelljen e tij si subjekt i procedurës penale gjatë tërë kohës.

2.f.3. I akuzuari A. Sh., në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se pajtohet plotësisht me fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, dhe ka shtuar se kërkon falje për të gjitha këto procedura të cilat ia ka shkaktuar gjykatës dhe prokurorisë, pendohet për veprimet e kryera por këto veprime i ka kryer në kohën e pandemisë, prej asaj kohe nuk i ka përsëritë, e po ashtu ka premtuar se nuk do ti përsërisë më në të ardhmen.

2.f.4. Mbrojtësi i të akuzuarit M..XH., , av. Korab Bokshi, në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, e cila është pjesë e shkresave të lëndës dhe të cilën e ka elaboruar në shqyrtimin gjyqësor, ka theksuar se dispozitivi i aktakuzës rezulton të jetë konfuz, i pa përcaktuar në kohë, hapësirë e aq më pak në veprime konkrete që pretendohet ti ketë kryer i pandehuri M.... Nga dispozitivi i akuzës lindin dilema se kujt i shiti narkotik i akuzuari M.. nga kush pranoi të holla, me kë është takuar apo biseduar i akuzuari M.. për shitje të narkotikëve, kush vërtetoi se i akuzuari M.. posedonte narkotik, kush e vërtetoi se i akuzuari M.. dëgjohe në masa të fshehta.



Më tutje ka parashtruar se përkundër faktit që masat e fshehta të vëzhgimit dhe hetimit nuk ndërlihet asgjë inkriminuese për të akuzuarin M, të njëjtat konsideron që janë edhe kundërligjore. Ndaj të akuzuarit M.. hetimet formale janë filluar me Aktvendimin PP/I.nr.04/2022 datë 14.02.2022. Aplikimi i masave të fshehta dhe përgjimi eventual retroaktiv është kundërligjor. I ka propozuar gjykatës që të liroj nga akuza të akuzuarin M.Xh., .

2.f.5. I akuzuari M.XH., , në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se pajtohet me deklarin e mbrojtësit të tij dhe nuk ka asgjë për të shtuar.

### *3. Përfundimi i shqyrtimit gjyqësor*

Me datë 05.03.2024 gjykata e ka shpallur të përfunduar shqyrtimin gjyqësor në këtë çështje penale, ndërsa shpallja e aktgjykimit është bërë me datë 07.03.2024.

### *4. Gjetjet e gjykatës lidhur me faktet*

Gjykata, pas procedimit të provave materiale dhe atyre personale në këtë shqyrtim gjyqësor, paraqitjes së fjalës përfundimtare nga palët në procedurë, duke e vlerësuar me ndërgjegje çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë, e në mbështetje të nenit 360 paragrafi 1 dhe 2 të KPPK-së, ka vërtetuar gjendjen faktike si në pikat I dhe II të këtij aktgjykimi.

### *5. Faktet jokontestuese*

Gjykata, si fakte që nuk janë kontestuar nga palët dhe kanë mbështetje në prova, ka vlerësuar:

-5.a.1. Faktin se i akuzuari A.SH., , ka shpërndanë, ndërmjetësuar dhe shitë tek personat e tretë si dhe ka poseduar lëndë narkotike të llojit Kokainë, me qëllim të shitjes në peshë të përgjithshme prej 87.59 +- 0.0001gram, dhe

-5.a.2. Faktin se i pandehuri M.XH., , me automjetin e markës “. . .”, ka shpërndanë, ndërmjetësuar dhe shitë tek personat e tretë, përkatësisht personit E.S-T., dhe A.B., në mënyrë të kundërligjshme substanca narkotike me qëllim të përfitimit material.

Faktet e lartcekura, nuk kanë qenë kontestuese ndërmjet palëve. Për më tepër, këto fakte vërtetohen edhe përmes provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, pra nga dëshmitë e dëshmitarëve dhe provave materiale.

### *5.b. Faktet kontestuese*

Gjykata, si fakt kontestues ka vlerësuar:

-5.b.1. Faktin se të akuzuarit A.SH., dhe M.XH., , a kanë shitur lëndë narkotike apo të njëjtat vetëm i kanë poseduar.

Pra, faktet e lartcekura kanë mbetur kontestuese për palët edhe pas administrimit të provave.

*6. Vlerësimi dhe analizimi i provave lidhur me pjesën gjyquese të akuzuarit A.SH., si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi*

Nga provat e administruara gjykata ka vërtetuar se i akuzuari A.SH., , nga data e pavërtetuar e deri me dt.30.04.2022, në Gjakovë, pa autorizim shpërndan, shet, transporton, dorëzon, ndërmjetëson, dërgon substanca psikotrope ose analoge të shpallura të rrezikshme në kundërshtim me nenin 9, nenin 14 të Ligjit për barnat narkotike substanca psikotrope dhe prekusore nr.02/L-128, dhe atë të llojit kokainë me qëllim të shitjes, të përshkruara si në pikën I të këtij aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar përmes provave personale dhe materiale si në vijim:

6.a.1. Deponimeve të dëshmitarit A.B., , gjykata ia fali besimin pjesërisht, përkatësisht në pjesën ku ka deklaruar se diku në orët e hershme të mëngjesit, është takuar me A.SH., , përveç kësaj ka deklaruar se është takuar shumë herë rastësisht se janë afër me shtëpi dhe A.i i ka treguar se i ka 1 kg, mall-kokainë të fshehur në tokë, këtë deklaram e ka dhënë në prokurori dhe të njëjtin e ka konfirmuar në gjykatë.

Ndërsa nuk ia fali besimin deklaramit të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor, me ç’rast ka deklaruar, se “duke pasur parasysh natyrën edhe të A.it, i cili bënë humor, e në shumicën e rasteve edhe i ka nguc personat që i ka pasur në kerr, duke bërë me mimikë që me e vazhdua humorin, e ka cekur edhe në prokurori se i ka përdor disa terma si emra të parfumeve, orizit, etj, por gjithmonë është munduar me iu përshtat humorit të A.it” po ashtu, ka deklaruar se po atë ditë, rreth orës 04,42/h, pasi që kohë pas kohe kanë luajtur bastore, me atë program që e ka pasur A..., u’a ka kryer atë shërbim, dhe ky ka qenë rasti që i ka kërkuar lojërat me na i krijua A...prej Mitrovicës, por ku është kthyer prej Mitrovicës ia ka gjuajtur të hollat. Këtij deklarami gjykata nuk ia fali besimin pasi që nga prova materiale e përgjimit vërtetohet se “me datë 31.01.2022, rreth orës 01.40, A.i me dëshmitarin A.B., tek shtëpia e tij në fund të rrugës “...”, i tregon se ka një kilogram Kokainë të egër me mbishkrimin ..., të cilën e ka të shtinë në orizë dhe e ka të fshehur në gjysmë metër në tokë dhe se e ka një kilogram tjetër me të butë të cilën e ka shitur 500 gram dhe se sipas Adh... kokaina e egër nuk shitet në dimër për vetëm kjo e buta”.

Po ashtu nuk ia fali besimin në pjesën ku ka deklaruar se “pasi që kohe pas kohe kanë luajtur bastore, me atë program që e ka pasur A...na e ka kryer atë shërbim, dhe ky ka qenë rasti që i ka kërkuar lojërat me na i krijua A... prej Mitrovicës, por ku jam kthyer prej Mitrovicës ia kam gjuajtur të hollat”. Këtij deklarami nuk ia fali besimin gjykata pasi që i njëjti deklaram është në kundërshtim me provën materiale të përgjimit, ku vërtetohet se i akuzuari A.SH., i jep narkotikun një personi në Gjakovë, dhe i tregon se “unë kam hapur një Kompani te Bastores ku klientëve të mi ju kam thënë që kur më telefonojnë të më thojnë qitmi 120 € (që don të thotë 3 qese kokainë nga 40 €) (dhe në rast se ju zejn najherë të thoni që kam luajtur bastore”, pra dëshmitari në rastin konkret ka deklaruar ashtu edhe siç janë marrë vesh paraprakisht me A... pasi që gjatë shqyrtimit ka deklaruar se “pasi që kohe pas kohe kemi luajtur bastore, me atë program qe e ka pasur Adh.. na e ka kryer atë shërbim, dhe ky ka qenë rasti që i ka kërkuar lojërat me na i krijua

*Adh.. prej Mitrovicës, por ku jam kthyer prej Mitrovicës ia kam gjuajtur të hollat*". Pra, ky dëshmitar nuk ka ofruar përgjigje të sakta por i njëjti përveçse nuk ka qenë korrekt me gjykatën, i njëjti është munduar edhe ta qes në lajthim gjykatën me deklaratimet e tij.

6.a.2. Me rastin e vlerësimit të deklaratave të dëshmitarit V.L., gjykata deklarimeve të këtij dëshmitari të dhëna në shqyrtim gjyqësor ia ka falur besimin plotësisht, e sidomos pjesës ku ka deklaruar se me A... njihet nëpërmjet babait të vet.

Ndërsa nuk ia fali besimin në pjesën ku ka deklaruar se arsyeja që i ka shkruar A.. me u takuar është sepse ka dashur për me e pyet për një punë, pasi që në atë kohë ka qenë i papunë. Po ashtu, nuk ia fali besimin pjesës së deklaratës së dhënë në shqyrtim gjyqësor ku ka deklaruar se "nuk ka blerë nga A.SH., , ndonjëherë substancë narkotike të llojit kokainë edhe pse në fakt ka thënë se e ka blerë, e këtë e ka thënë në polici dhe prokurori, këtë deklaram e ka thënë sepse ka pasur një stresë-ngarkesë, pra, e ka pasur një rast, dhe ka qenë shumë i ngarkuar psikikisht në ato momente atëherë sepse e ka pasur një rast personal në gjykatë dhe polici, ku ia kanë nxënë disa lëndë narkotike – marihuanë", pasi që është në kundërshtim me deklaratat e tij të dhëna në polici dhe prokurori ku i njëjti ka deklaruar se "*vetëm një herë kam marrë nga i njëjti një dozë të llojit kokainë dhe për këtë kam paguar 40 €, në ....., tek kafiteria "...", para lokalit ku i ka shkruar në instagram dhe jam takuar me të, ma dha si fshehtë në një pako të cigareve e kishte pasur them në sasi 0.03 gram, por prapë nuk e di sasinë saktë, por e njëjta është e mjaftueshme për një ditë, substancë kjo kokainë*".

6.a.3. Me rastin e vlerësimit të deklaratave të dëshmitarit Ç.SH., gjykata deklarimeve të këtij dëshmitari të dhëna në shqyrtim gjyqësor ia ka falur besimin pjesërisht, përkatësisht në pjesën ku ka deklaruar se A.SH., , në vijë ajrore e ka rreth 1000 metra larg, ka pasur kontakt me të, përshëndetje me njeri tjetrin dhe ende vazhdojnë të përshëndeten me njeri tjetrin, por kontakte nëpërmjet rrjeteve sociale apo përmes telefonit nuk kanë. Dëshmitaren M.XH., e cila e ka nofken ...e njeh, dhe me te është takuar në shkurt të vitit 2022 në villa, "... në Piskotë. Në kohën kur ka qenë me M., pra në muajin Shkurt 2022.

Ndërsa nuk ia fali besimin në pjesën ku ka deklaruar gjatë shqyrtimit gjyqësor se "...i sa ka qenë me te nuk ka porositur kokainë në sy të tij, jo, mirëpo telefonin nuk ia ka kontrolluar. Është takuar në villën "...", me M..n, ku prezent ka qenë edhe E.h., , Z.G., dhe M...a, ka qenë orë policore, sa e mban mend nuk kanë pasur ku të rrinë, dhe kanë shkuar në villa. Atë natë nuk e dinë se a ka porositur ndokush nga ta kokainë, pasi që dëshmitari ka qenë në ndikim të alkoolit dhe ka flejt ne gjumë "pasi që ky deklaram është në kundërshtim me deklaramin e dhënë në prokurori të dëshmitares M.XH., ku ka deklaruar se "*Ç... e ka thirrë A.SH., për të sjellë kokainë aty tek villa ... dhe A...i me një "pick up" të bardh na ka sjellë kokainë*"

Po ashtu, gjykata nuk ia fali besimin në pjesën ku ka deklaruar gjatë shqyrtimit gjyqësor se "nga A.SH., nuk ka blerë substanca narkotike", pasi që ky deklaram i tij është në kundërshtim me deklaramin e dhënë në polici, ku i njëjti ka deklaruar se "*nga A.i ka blerë kokainë disa herë doza të vogla kryesisht 0.2gr, 0.3 gr*". I njëjti ka shtuar se, këtë deklaram e ka bërë pasi që i kanë bërë

presion policia, por asnjëherë nuk ka dëshmuar se me të vërtetë e ka pasur një presion të tillë pasi që nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se është ankuar për presionin e policisë.

6.a.4. Me rastin e vlerësimit të deklaratave të dëshmitarit E.K., gjykata deklarimeve të këtij dëshmitari të dhëna në shqyrtim gjyqësor ia ka falur besimin pjesërisht, përkatësisht lidhur me pjesën jokontestuese ku i njëjti ka deklaruar se D.K., o e njeh pasi që jetojnë në një lagje.

Po ashtu Gjykata ja fali besimin deklarimit të tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor kur ka deklaruar se ka qenë në tavolinë në pompën HIB, dhe me ta ka qenë edhe një shoqe, A.E. dhe gjatë tërë kohës nuk ka qëndruar D...në tavolinë me ta. D... një qese e ka lënë në tavolinë, por është larguar direkt dhe ka shkuar në fshatin Xërxë, pra, ai e ka lënë një qese të zezë, të thatë në tavolinë, dëshmitari ka qenë në .. me shoqen, ai ka kërkuar telefon nga unë, një telefon ja ka dhënë shoqja A., sepse nuk kisha telefon, ndërsa nuk ja fali besimin në pjesën ku ka deklaruar se “..e ka marr dhe e ka kqyr çka ka dhe e ka lënë në banjo sepse ka qenë e thatë”, pasi që e njëjta është në kundërshtim me deklaratën e dëshmitarit D.T., ku i njëjti ka treguar se “*sendi që e ka marrë prej atij personi ka qenë pak lëndë narkotike*”, si dhe në deklaratën e dhënë në polici ka deklaruar se “*Ernesti ka marr telefonin tim në banjo dhe aty nga telefoni im kishte konsumuar substancë narkotike. Këtë gjë e ka vërejtur kur ka marr telefonin dhe ka shkruar në banjo ta pastrojë dhe aty ka vërejtur mbetje të kokainës*”.

6.a.5. Me rastin e vlerësimit të deklaratave të dëshmitares M.XH., , gjykata deklarimeve të saj, të dhëna në shqyrtim gjyqësor, ia ka falur besimin pjesërisht, përkatësisht lidhur me pjesën jokontestuese ku ka deklaruar se me datë 20.02.2022, ka qenë në motelin “...”, që ndodhet në fshati .... ka qenë me Ç... në dhomë si shok, telefonin e saj e ka përdorur Ç...pasi që e njëjta deklaratë gjenë mbështetje edhe në deklaratën e dhënë në Prokurori dhe Polici.

Ndërsa nuk ia fali besimin në pjesën ku ka deklaruar, se “se çka ka shkruar Ç... me A.. nuk dinë”, pasi që e njëjta deklaratë është në kundërshtim të plotë me deklarimin e saj të dhënë në polici dhe prokurori ku ka deklaruar se “*pasi që konsumoi sasinë që kishte me vete Ç.. ai me kërkoi telefonin tim dhe ka thirrë personin e quajtur A.SH., nga i cili ka kërkuar që në Motel M.. ti sjell tre doza me kokainë*”

E njëjta për këtë ndryshim të deklaratës është arsyetuar se kur e ka dhënë deklaratën ka qenë një muaj-një muaj e gjysmë para lindjes, ose më pak dhe kur e ka dhënë deklaratën ka qenë në gjendje me thënë po, çka do që t’i thonë, sepse ka qenë në gjendje psikike, e stresuar para lindjes.

Po ashtu, deklarimit të dhënë në shqyrtim gjyqësor se me datë 27.02.2022, ka qëndruar në motelin “...” dhe ka qenë Ç...E.i, një person tjetër i Prishtinës. Q... nuk e dinë kë e ka thirr, por, i kujtohet se ka thirr me emrin .., dhe i ka thënë thirre A..

Gjykata ia fali besimin edhe deklaratës së dhënë në polici dhe prokurori ku e njëjta në mënyrë kronologjike ka treguar se “Ç..e ka thirrë A. për të sjellë kokainë, tek ... dhoma nr.1, dhe A.. ka shkuar me një “pick up”, të bardhë dhe ju ka sjellë kokainë, dhe e njëjta ka sqaruar se në villa ka qenë 2-3 herë brenda muajit Shkurt, me tre personat (Ç.. Zh., E,H., dhe një shok i Prishtinës), ku ju ka sjellë A.. kokainë, ka pasur raste tjera që kur kokainën e ka sjellë edhe me një shokë,

dhe se kokainën kur e ka sjellë tek villa në Gjakovë, ja ka dhënë E.H., i cili i jepte herë 20 €, herë hynte borxh tek A. e herë ka marrë 02 gram, 0.3 gram, 0.5 gram, ku e përdornin që të tre, duke e thithur me hundë. Po ashtu e njëjta ka treguar se ka pasur rast kur edhe vetë e ka thithur kokainën.

Ndërsa e njëjta gjatë deklarimit gjatë shqyrtimit gjyqësor ka theksuar se nuk i kujtohet saktë çka ka deklaruar në polici.

6.a.6. Me rastin e vlerësimit të deklaratave të dëshmitarit D.T., gjykata deklarimeve të këtij dëshmitari të dhëna në shqyrtim gjyqësor ia ka falur besimin, përkatësisht lidhur me pjesën ku ka deklaruar se me datë 28.02.2022, diku rreth orës 18:00, derisa ka qenë me shokun e tij, E.. K., në pompën e derivateve “..” në Gjakovë, E.e ka marrë telefonin e tij dhe i ka shkruar dikujt e më pas D... i ka thënë që të dal jashtë dhe të marrë diçka, dhe kur ka dal D.. në një veturë kanë qenë dy persona A.SH., dhe një person tjetër, ku pasagjeri ia ka dhënë A..t një qese pluhur të bardhë kokainë, A. i ka thënë amon ma shpejt se po me merr në qafë, ku më pas ia ka dhënë A.. shumë prej 40 €, dhe këtë substancë e ka përdorur shoku i tij, E. në banjo dhe vet e ka përdorur pak. Këtij deklarimi gjykata ja fali besimin pasi që i njëjti gjen mbështetje edhe në deklaratën e dhënë të dëshmitarit E.K., i cili gjatë këtij shqyrtimi ka cituar se “qesen e ka marrur dhe ka shkruar në banjo”, por i njëjti nuk e ka pohuar faktin se e ka përdorur atë narkotik.

6.a.7. Gjykata e ka vlerësuar edhe deklaratën e dëshmitarit M.G., të dhënë në polici, prokurori dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor mirëpo, këto deklarata të të bashkëpandehurit nuk mund të përdoren si provë, duke u bazuar në nenin 123 të KPP-së, (i cili është në fuqi) tek dëshmitarët e privilegjuar, ku në paragrafin 1, nën-paragrafi 1.3 parashihet se: “i bashkëpandehuri derisa zbatohet procedurë e përbashkët apo e veçuar, përveç kur i bashkëpandehuri është dëshmitar bashkëpunues sipas nenit 231 të këtij Kodi”.

6.a.8. Gjykata ka vlerësuar edhe deklaratën e të pandehurit të dhënë në polici, ku i njëjti nuk e ka kontestuar faktin se ka bërë shpërndarjen e kokainës me . . . dhe me Dacia, dhe parat që janë gjetur herën e parë në shumën prej 5000 €, kanë qenë para të fituara nga shitja e kokainës, ka shtuar se një gram kokainë e ka shitur 70 deri 80 €. Këtij deklarimi gjykata ja fali besimin e plotë pasi që i njëjti gjen mbështetje edhe në provat materiale dhe personale, përkatësisht në masat e fshehta ku i njëjti dëgjohet duke thënë se “për një muaj e njëzet ditë ka fituar 70.000 €, që sipas tij për çdo ditë ka fituar nga 1350 €, nga shitja e narkotikëve dhe thotë se nga paratë që kishte të paluara kishte marrë vetëm 10.000 € për mall dhe më pastaj kishte fituar 70.000 €”.

7. Vlerësimi dhe analizimi i provave lidhur me pjesën gjyqësore të akuzuarit M.XH., si në piken II të dispozitivit të këtij aktgjykimi

Gjykata, pasi që ka analizuar të gjitha provat në rastin konkret ka konstatuar se nga koha e pacaktuar e deri në fillim të Marsit të vitit 2022, në Gjakovë, pa autorizim shpërndan, shet, transporton, dorëzon, ndërmjetëson, dërgon substanca psikotrope ose analoge të shpallura të rrezikshme në kundërshtim me nenin 9 nënparagrafi 14 të Ligjit për barnat narkotike substanca psikotrope dhe prekusore nr.02/L-128, e me qëllim të shitjes, dhe atë në mënyrën e përshkruar si në dispozitivin nën II të këtij aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar përmes provave personale dhe materiale si në vijim:

7.a.1. Me rastin e vlerësimit të deklaratave të dëshmitares E.s-T, gjykata deklarimeve të kësaj dëshmitareje të dhëna në shqyrtim gjyqësor ia ka falur besimin pjesërisht, përkatësisht në pjesën ku ka deklaruar se M.XH., ka punuar te lokali ...” kuzhinier, ku edhe tani punon dhe ky lokal gjendet në lagje në afërsi të banesës së saj.

Ndërsa nuk ia fali besimin në pjesën ku gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se “nuk është përdoruese, nuk ka blerë substanca narkotike as nga M.. e as nga A.., e njëjta ka sqaruar se nuk ka blerë substanca narkotike e as nuk ka qenë përdoruese e drogës” sepse e njëjta deklaratë është në kundërshtim me deklaratën e dhënë në prokurori, ku e njëjta ka treguar në mënyrë kronologjike se “*ka kontaktuar me M. në telefon dhe kështu ka filluar të konsumoj narkotik të llojit Kokainë, i njëjti i ka shitur disa herë kur ka pasur nevojë, po ashtu M... ka pasur bashkëpunim me A.sH., , sepse një herë kur i ka sjellë kokainë tek banesa e që është afër policisë-afër lokalit ku punon M..ka qenë natë, tek vetura kur ka dal për me e marrë substancën e llojit kokainë të cilën ia ka dhënë M.i në sasi prej 1-2 substancë qese*”, kësaj deklarate gjykata ja fali besimin pasi që e njëjta gjenë mbështetje edhe në provën materiale të përgjimit nga ana e zyrtarëve policor, ku nga dosja 182 me datë 01.02.2022, dëgjohen të pandehurit M.XH., dhe A.SH., të cilët shkojnë afër një banese për të dërguar kokainë tek një femër, ku i pandehuri M... zbret nga automjeti dhe ngjitet lartë, e pasi kthehet i pandehuri M., thotë ku çfarë femre ishte dhe aty përmendet kokaina 40 €, dhe lokacioni ku ata janë ndaluar ka qenë rruga “A. Mojsiu”, ku narkotiku i është dërguar dëshmitares E.S-T,.. Po ashtu, nga dosja 486 me datë 18.02.2022, nga masa e përgjimit kuptohet se brenda në automjet është i pandehuri M.XH., , i cili thirret në telefon nga dëshmitarja E.S-T.,, ku M...i thotë të zbres poshtë banesës, tek vendi ku lija veturën “Pick up” përpara, ku e njëjta zbret poshtë takon të pandehurin M. dhe i merr një dozë kokaine 0.50 gram, ku dëgjohet i pandehuri M.XH., duke i thënë se paskan vendosur edhe kamera.

Edhe nga dosja 179 e datës 01.02.2022, dëgjohen të pandehurit ASH., dhe M.XH., ë cilët shkojnë në afërsi të shtëpisë së dëshmitarit A.B. dhe i shesin narkotik dhe dëgjohen duke i thënë a tu dok se është mall ma light (ma e butë).

Po ashtu, gjykata nuk ia fali besimin ku gjatë shqyrtimit ka deklaruar se “nuk i kujtohet asgjë çka ka deklaruar në polici dhe prokurori pasi që ka qenë nën ndikim të hapave, ka qenë paciente e F.A., dhe I.G., si dhe ka qenë nën depresion të shkallës së lartë”, e njëjta nuk ka sjellë prova se ka qenë nën ndikim të hapave, sepse përkundër asaj se gjatë shqyrtimit gjyqësor është obliguar që ti sjell provat-raportet mjekësore së bashku me rekomandimet e tyre për periudhën kohore nga muaji 01.03.2022, e deri me datë 01.08.2022, e njëjta asnjëherë nuk i sjellë ato prova.

#### 8. Vlerësimi i gjykatës rreth pretendimeve të palëve në fjalën përfundimtare

Gjykata ka analizuar dhe vlerësuar pretendimet e prokurores se shtetit të dhëna në fjalën e saj përfundimtare dhe gjeti se të njëjtat janë plotësisht të bazuara në kuptim të gjetjeve të gjykatës. E njëjta në fjalën përfundimtare ka theksuar se “*Nga provat materiale të siguruar dhe të administruara në shqyrtimin gjyqësor, rezulton se të akuzuarit M.XH., dhe A.sH., me veprimet e*

tyre kanë konsumuar veprat penale të përshkruara nën pikën 1 dhe 2 të aktakuzës që prokurori i shtetit e përfaqëson, nga se nga këto prova rezulton se substancat narkotike të llojit kokainë në sasi të e cekura si në aktakuzë, të njëjtit i kanë shitur dhe kjo është vërtetuar nga rezultati i aplikimit të masave të fshehta, e që e njëjta ka mbështetje në provat tjera materiale dhe personale”, por gjykata ashtu siç e ka elaboruar detajisht si më sipër ka vërtetuar pretendimet e prokurorisë nga ana e provave materiale, përkatësisht nga masa e përgjimit dhe nga provat personale të dëshmitarëve të cekur me lartë. Andaj gjykata edhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit a.SH., av. Meshari Selimaj në fjalën e tij perfundimtare, ashtu që vlerësoi se pretendimet që “*gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor nuk janë vërtetuar pretendimet si në dispozitiv të aktakuzës se kush janë "personat të ndryshëm" që i pandehuri iu ka shitur narkotikun për çka asnjë nga dëshmitarët e prokurorisë nuk ka deklaruar në shqyrtim gjyqësor se kanë blerë narkotik nga i pandehuri A..pastaj cilat janë ato fshatra të komunës së Gjakovës, ku i njëjti e ka shitur narkotikun, apo shprehja e përmendur „edhe më gjerë" çka është vërtetuar me shprehjen e dhënë "edhe më gjerë":' kinse për shitje të narkotikut"* gjykata pretendimet e mbrojtjes i konsideron si të pabazuara pasi që nga provat materiale dhe personale, më konkretisht nga masat e fshehta-provë e cila është administruar gjatë këtij shqyrtimi është vërtetuar se i pandehuri A., ka kryer veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit M.Xh., av. Korab Bokshi, në fjalën e tij perfundimtare, ashtu që vlerësoi se pretendimet se “*dispozitivi i aktakuzës rezulton të jetë kofuz, i pa përcaktuar në kohë hapësirë e aq më pak në veprime konkrete që pretendohet ti ketë kryer i pandehuri M..., nga dispozitivi i akuzës lindin dilema se kujt i shiti narkotik i akuzuari M., nga kush pranoi të holla, me kë është takuar apo biseduar i akuzuari M.. për shitje të narkotikëve, kush vërtetoi se i akuzuari M.. posedonte narkotik, kush e vërtetoi se i akuzuari M.....dëgjohet në masa të fshehta*”. Ky pretendim është i pabazuar, pasi që nga provat materiale përkatësisht nga masat e fshehta vërtetohet me saktësi se i akuzuari M., ka bërë shitjen e narkotikëve dhe i njëjti disa herë i ka shitur personit E.S-T., me saktësisht siç është e specifikuar në deklaratën e dëshmitares të dhënë në Prokurori dhe nga prova materiale e përgjimit. Po ashtu gjykata ka vlerësuar edhe pretendimin se “*përkundër faktit që masat e fshehta të vëzhgimit dhe hetimit nuk ndërlihet asgjë inkriminuese për të akuzuarin M..të njëjtat konsideroj që janë edhe kundërligjore. Ndaj të ak. M... hetimet formale janë filluar me Aktvendimin PP/I.nr.04/2022 datë 14.02.2022. Aplikimi i masave të fshehta dhe përgjimi eventual retroaktiv është kundërligjor*”, ky pretendim është i pabazuar pasi që gjatë përgjimeve është dëgjuar edhe i akuzuari edhe M.XH., që është duke kryer veprën penale të shitjes së narkotikëve dhe gjykata provat e marra gjatë përgjimit i ka konsideruar si të ligjshme konform nenit 86 par.3 të KPPK-së, i cili përcakton se “*Për autorizimin e masave të veçanta hetimore nga paragrafi 1 dhe 2, të këtij neni prokurori i shtetit ose gjyqtari i procedurës paraprake nuk është e domosdoshme të ketë dyshim të arsyeshëm për identitetin e të dyshuarit apo të dyshuarve të cilët kanë kryer, janë duke kryer ose së shpejti do të kryejnë veprën penale*” dhe paragrafin 4 i cili përcakton se “*Procedura penale nuk është e domosdoshme që të jetë filluar*”

Për autorizimin nga prokurori i shtetit apo gjyqtari i procedurës paraprake të masave të veçanta hetimore nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni. Megjithatë, procedura penale fillohet posa prokurori i shtetit të ketë dyshim të arsyeshëm për identitetin e të dyshuarit apo dyshuarve që kanë kryer vepër penale”, po ashtu gjykata është bazuar edhe në nenin 95 i KPPK-së, ka përcaktuar se “Nëse provat e siguruar me anë të urdhrin për masat e veçanta hetimore, përfshijnë vepra penale tjera apo të dyshuar tjerë që nuk kanë qenë të përfshirë në urdhrin e lëshuar, ajo pjesë e regjistrimeve do të transkribohet dhe dorëzohet tek prokurori i shtetit dhe materiali i tillë mund të përdoret si provë në procedurë, vetëm nëse lidhet me një vepër penale për të cilën mund të lëshohet urdhri për masa të fshehta hetimore”.

#### *9. Propozimet e palëve*

Palët në procedurë nuk kanë pasur propozime tjera për nxjerrjen e ndonjë prove.

#### *10. Gjendjet faktike të vërtetuara dhe vendimet e kryetarit të trupit gjykues*

Pas administrimit të gjitha provave gjate shqyrtimit gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- Në veprimet e të akuzuarve A.SH., dhe M.XH., janë manifestuar për secilin veç e veç të gjitha elementet qenësore të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 parag.2 të KPRK-së, me datë, kohë dhe vend të përshkruar si në dispozitivin nën I dhe II të këtij aktgjykimi.

#### *11. Elementet e veprave penale*

Vepra penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 prg.2 të KPRK-së, parashihet se: “Kushdo që pa autorizim shpërndan, shet, transporton, dorëzon, ndërmjetëson, dërgon ose dërgon në transit substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope ose substanca analoge, me qëllim të shpërndarjes, shitjes ose ofrimit për shitje, dënohet me ...”. Pra, këtë vepër mund ta kryej çdo person, pra kushdo që shpërndan, shet, transporton, dorëzon, ndërmjetëson, ose dërgon në transit substanca narkotike. Pra, me vetëm njërin prej këtyre veprimeve plotësohen kushtet që të jetë përgjegjës sipas kësaj dispozite.

#### *12. Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit*

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese të parapara në nenet 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Për të akuzuarin A.SH., si rrethana rënduese gjykata ka gjetur:  
-shkallën e përgjegjësisë penale, pasi që gjykata ka vërtetuar se i pandehuri ishte i përgjegjshëm dhe përgjegjës për këto vepra penale, i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e tij;



-Rrezikshmëria - vlera e mbrojtur shoqërore, veprat penale të narkotikut, gjithnjë e më shumë po shkojnë drejt trendit të rritjes, ku trendi i rritjes së këtyre veprave penale në shoqëri dhe sasia/lloji i narkotikut të konfiskuar në këtë çështje penale, tregon shkallën e rrezikshmërisë së lartë të kësaj vepre penale (rrezikshmërinë e lartë të veprimeve inkriminuese të këtyre të akuzuarve), ku kjo rrezikshmëri e lartë kriminale, cenon edhe vlerat më të mbrojtura shoqërore, jetën dhe shëndetin e qytetarëve, posaçërisht ku përdorues të narkotikut janë grup-moshat e reja si vlerë e rëndësishme e shoqërisë.

Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar:

- rrethanat personale të të akuzuarit, është i martuar, i ati i një fëmije, i akuzuari para këtij rasti ka qenë i dënuar sipas aktgjykimit P.nr.296/20, për shkak të veprës penale nga neni 269/1-2 të KPRK-së, me dënim me gjobë në shumën prej 300 Euro, dhe i njëjti është bërë i plotfuqishëm me datë 22.01.2021.

Për të akuzuarin M.XH., , si rrethana rënduese gjykata ka gjetur:

-shkallën e përgjegjësisë penale, pasi që gjykata ka vërtetuar se i pandehuri ishte i përgjegjshëm dhe përgjegjës për këto vepra penale, i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e tij;

-Rrezikshmëria - vlera e mbrojtur shoqërore, veprat penale të narkotikut, gjithnjë e më shumë po shkojnë drejt trendit të rritjes, ku trendi i rritjes së këtyre veprave penale në shoqëri dhe sasia/lloji i narkotikut të konfiskuar në këtë çështje penale, tregon shkallën e rrezikshmërisë së lartë të kësaj vepre penale (rrezikshmërinë e lartë të veprimeve inkriminuese të këtyre të akuzuarve), ku kjo rrezikshmëri e lartë kriminale, cenon edhe vlerat më të mbrojtura shoqërore, jetën dhe shëndetin e qytetarëve, posaçërisht ku përdorues të narkotikut janë grup-moshat e reja si vlerë e rëndësishme e shoqërisë.

Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar:

- rrethanat personale të të akuzuarit, është i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, i akuzuari më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale.

Andaj, duke pasur parasysh të lartcekurat, në harmoni edhe me politikën ndëshkimore të aprovuar nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, gjykata ka ardhur në përfundim se dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, janë adekuate me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve dhe është e bindur se me këto dënime do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-se, dhe i njëjti është në proporcion me peshën e veprave penale, me sjelljen dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit, si dhe konsiston në parandalimin e kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, si dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

### *13. Vendimi për llogaritjen e paraburgimit*

Në nenin 79 paragrafi 1 të KPRK-së është përcaktuar si vijon: Koha e kaluar në paraburgim, arrest shtëpiak si dhe çdo periudhë e heqjes së lirisë lidhur me veprën penale llogariten në

dënimin e shqiptuar me burgim, burgim për të mitur, në masën edukative institucionale dhe dënimin me gjobë.

Në mbështetje të dispozitës së lartcekur, gjykata, kohen e kaluar nën masën e paraburgimit të akuzuarit A. Sh., nga data 30.04.2022 e deri me datën 24.01.2023, ia ka llogaritur në dënimin e përcaktuar me burgim.

#### *14. Vendimi mbi konfiskimin*

Përveç dënimit kryesor, gjykata ka vendosur që ndaj të akuzuarve të konfiskohen mjetet/sendet që janë përdorur me qëllim të kryerjes së veprës penale dhe të cilat janë dobi pasurore e fituar me kryerjen e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka bërë edhe konfiskimin e substancës narkotike të llojit Kokainë dhe atë: 229 qese të tejdukshme me substancë pluhuri, me ngjyrë të bardhë, të llojit kokainë, dhe ato në përbërje prej: një qese në sasi prej 0.34 gram, një qese në sasi prej 0.39 gram, një qese në sasi prej 0.36 gram, një qese në sasi prej 0.39 gram, 14 të qese në sasi bruto prej 5.89 gram, 45 qese në sasi bruto prej 18.82 gram, 46 qese në sasi bruto prej 19.31 gram, 45 qese në sasi bruto prej 18.49 gram, 35 qese në sasi bruto prej 16.41 gram, 40 qese në sasi bruto prej 16.30 gram, të gjitha së bashku në peshë të përgjithshme prej 87.59 +- 0.0001gram, konform nenit 267 paragrafi 5 të KPRK-së.

Po ashtu, gjykata konform nenit 277 paragrafi 1 të KPP-së, nga i akuzuari A.SH., ka konfiskuar: Mjetet monetare në shumën prej 5,178.20 € dhe 500 lek të Shqipërisë, si mjete të përfituara përmes kryerjes së veprës penale, dhe një telefon mobil i lloji “Iphone X”, ngjyrë e zezë, me IMEI 353054094307469, së bashku me një sim kartel “vala”, i përdorur nga ana e të pandehurit me qëllim të kryerjes së veprës penale, dhe një veturë “. . .”, me trg. . . ., me nr. të shasisë VSX000073P6018188, shfrytëzues A.SH., , pronar D.M., , i përdorur me qëllim të kryerjes së veprës penale.

Nga i akuzuari M.XH., ka konfiskuar: Paratë e gatshme në shumën prej 657 €, 17 dollar, 70 funta, 100 franga zvicerane dhe 3000 lek të Shqipërisë dhe një telefon mobil i llojit “Iphone 7 plus”, ngjyrë e zezë, së bashku me sim kartel me nr. . . ., i përdorur nga ana e të pandehurit me qëllim të kryerjes së veprës penale dhe një veturë “. . .”, ngjyrë e gjelbër, me trg....., me nr. Shasisë UU1LSD4AH34634469, shfrytëzues M.XH., , me pronar Makfirete Bina nga Prishtina, i përdorur me qëllim të kryerjes së veprës penale dhe një çelës të veturës.

Gjykata ka urdhëruar kthimin e telefonit mobil të lloji “Iphone”, ngjyrë e zezë, me sim kartelën 0... pronë e dëshmitarit M.G., nga Gjakova, rruga ...nr. 40, si dhe automjeti i markës “Ford Focus”, ngjyrë hiri, me targa .., numri i shasisë: WFOAXXGCDAXS10520, me pronar: M.B., numri personal: . . ., banues në fshatin.. Komuna Gjakovë, së bashku me qelës të automjetit si dhe certifikata e regjistrimit të automjetit me nr. CRA 1829529, meqenëse gjatë kësaj procedure nuk është vërtetuar se janë shfrytëzuar si mjete për kryerjen e veprës penale.

#### *15. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike*

Kërkesë pasurore-juridike nuk kishte.

*16. Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale*

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për të akuzuarit është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 në lidhje me nenin 452 par. 1 të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par.3 nënpar.3.2 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Gjykata nga arsyet e cekura si me lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, përkatësisht për pikën I dhe II duke u bazuar në nenin 364 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**

*-Departamenti për Krime të Rënda-*

PKR.nr.108/22 datë 04.04.2024

Bashkëpunëtori profesional,  
Zef Qupi

Kryetari i trupit gjykues,  
Ilir I. Rashkaj

**KESHILLE JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.